



Monitorimi nga Shoqëria Civile

i Zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe i Planit të Veprimit
të Dekadës Rome në vitin 2012 në

Shqipëri

Monitorimi nga Shoqëria Civile

i Zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe i Planit të Veprimit të
Dekadës Rome në vitin 2012 në

SHQIPËRI

Përgatitur nga një koalicion i shoqërisë civile që përfshin organizatat e mëposhtme:

Roma Active Albania (organizata drejtuese) ■ Qendra e Nxitjes së Zhvillimit Njerëzor
O Avipe i Romegno ■ Romano Sezi ■ Unioni Rom i Beratit



Shkruar nga

Ylli Cabiri ■ Adriatik Hasantari ■ Lindita Rama ■ Ivia Bajrami ■ Dritan Ziu ■ Gerta Xega
Latif Kazanxhiu ■ Enver Mustafaj ■ Laver Myrteli ■ Selvie Rushiti ■ Renart Koci ■ Albana Nuredini ■ Hafize Peqini

Hartuar nga

Koordinuar nga Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome,
në bashkëpunim me programin Shfrytëzimin Maksimal të Fondeve të BE-së për Romët dhe Zyrën
e Iniciativave Rome të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur



Publikuar nga

Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation

Teréz körút 46.

1066 Budapest, Hungary

www.romadecade.org

Dizenjoja dhe formatimi: www.foszer-design.com

©2013 by Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem për rigjenerimin e të dhënave ose transmetohet në ndonjë formë ose mjet, pa lejen e Botuesit.

ISSN: 2064-0706

Të gjitha raportet e monitorimit të shoqërisë civile janë të disponueshme në adresën www.romadecade.org

Ky raport u përgatit nga një koalicion i shoqërisë civile që përfshin organizatat e mëposhtme: Roma Active Albania (organizata drejtuese), Qendra e Nxitjes së Zhvillimit Njerëzor (HDPC), O Avipe i Romegno, Romano Sezi, Unioni Rom i Beratit.

Kërkuesi kryesor i koalicionit është Ylli Cabiri, Doktor i Shkencave (HDPC) dhe menaxheri i projektit është Adriatik Hasantari (RAA). Autorët e raportit janë: Ylli Cabiri (Autori Udhëheqës), Adriatik Hasantari (RAA), Lindita Rama, Doktore e Shkencave (HDPC), Ilvia Bajrami (RAA), Dritan Ziu (RAA), Gerta Xega (RAA), Latif Kazanxhiu (RAA), Enver Mustafaj (Romano Sezi), Laver Myrteli (Unioni Rom i Beratit), Selvie Rushiti (O Avipe i Romengo), Renart Koci (student), Albana Nuredini (studente) dhe Hafize Peqini (studente).

Në projekt janë angazhuar, gjithashtu, personat e mëposhtëm: Renard Koci, Blerina Zoto, Albana Nuredini, Hafize Peqini, Anila Harapi, Klaudia Veizaj, Ina Majko, Ledia Rushit, Klaudio Taho, Daniel Hyseni, Erion Mejdani, Xhekson Çela, Saimir Kazanxhiu, Donika Rrapushi, Eva Tare dhe Egla Rrapushi.

Gjatë përgatitjes së raportit janë përfshirë edhe organizatat e mëposhtme: Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome, Departamenti i Politikës Publike i Universitetit European Qendror, Qendra Europiane e të Drejtave Rome, Organizata "Habitat for Humanity", Fondi i Arsimit Rom dhe nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur: Shfrytëzimi i Fondeve të BE-së për Programin Rom, Zyra e Iniciativave Rome dhe Programi Rom mbi Shëndetësinë.

Në vitin pilot 2012, Sekretariati i Dekadës Rome vendosi të mbështesë raporte nga koalicionet e shoqërisë civile në shtatë vende (Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Maqedonia, Rumania, Sllovakia, dhe Spanja) dhe Zyra e Iniciativave Rome autorizoi një raport shtesë nga Republika Çeke. Përveç kësaj, Sekretariati i Dekadës Rome publikoi një model, me qëllim nxitjen e aktorëve të tjerë të shoqërisë civile për të monitoruar zbatimin e Strategjive Kombëtare për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Planet e Veprimt të Dekadës Rome.

Në këto raporte, koalicionet e shoqërisë civile plotësojnë ose paraqesin informacion alternativ të Raporteve të Progresit të Dekadës Rome të paraqitura nga Qeveritë Pjesëmarrëse në Dekadën e Përfshirjes Rome dhe për çdo raport të paraqitur nga Shtetet palë në Komisionin European mbi zbatimin e Strategjive të tyre. Këto raporte nuk synojnë të zëvendësojnë monitorimin dhe vlerësimin sasior nga autoritetet shtetërore por të kanalizojnë njohuritë lokale në proceset e politikave kombëtare dhe europiane dhe të reflektojnë mbi ndikimin social real të masave qeveritare. Raportet e shoqërisë civile ofrojnë të dhëna shtesë ndaj atyre zyrtare, të dhëna përfaqësuese, kur nuk ka të dhëna zyrtare, ose interpretim alternativ të të dhënave të publikuara.

Projekti koordinohet nga Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome në bashkëpunim me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur – Shfrytëzimi i Fondeve të BE-së për Programin Rom dhe Zyrën e Iniciativave Rome.



TABELA E LËNDËS

Përmbledhje Zbatuese	7
Rekomandime	13
Shkurtime	17
Hyrje	19
1. Kërkesat Strukturore	23
2. Anti-Diskriminimi	27
3. Arsimi	37
4. Punësimi	45
5. Kujdesi Shëndetësor	51
6. Strehimi	55
Shtojca: Pyetëtori	61
Bibliografia	67



PËRMBLEDHJE ZBATUESE

Hyrje

Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje stabilizimi asociimi me Bashkimin Europian në vitin 2006 dhe po bëhet pjesë aktive e dialogut të rregullt politik dhe ekonomik, duke paraqitur gjithashtu kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Europian. BE-ja i ka ofruar Shqipërisë asistencë financiare në kuadrin e para-aderimit, duke u fokusuar në çështjet e brendshme dhe ato të drejtësisë, reformën e administratës publike, transport, mjedis, ndryshimet klimaterike, zhvillimet sociale dhe zhvillimet bujqësore e rurale. Veç kësaj Shqipëria është pjesë e programeve për bashkëpunim ndërkufitar dhe transnacional të BE-së dhe shoqëria civile shqiptare merr mbështetje financiare për projekte në fushën e drejtësisë, në atë të mbrojtjes së grupeve në nevojë (gratë në situatë të pafavorshme, fëmijët dhe të moshuarit, grupet minoritare) dhe në fushatën e mbrojtjes së mjedisit.

Komuniteti rom është konsideruar si komuniteti më i cenuar në Shqipëri, që përballlet me varfëri të skajshme, marzhinalizim social-ekonomik dhe diskriminim të vazhdueshëm, në veçanti për të drejtën e arsimit, mbrojtjes sociale, kujdesit shëndetësor, punësimit dhe të strehimit të përshtatshëm. Romët nuk njihen publikisht si minoritet i veçantë dhe ata kanë statusin e një minoriteti etnolinguistik. Megjithatë Kushtetuta e Shqipërisë trajton të gjitha parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe minoriteteve. Shqipëria, gjithashtu, është pjesë e traktateve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve.

Shqipëria nuk ka një Strategji Kombëtare për Integrimin e Komunitetit Rom. Megjithatë, disa masa të politikave në favor të përfshirjes sociale të romëve janë ndërmarrë nga qeveria shqiptare. Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve 2003-2013 u miratua në 2003 dhe u pasua nga Plani i Veprimit i Dekadës Rome 2010-2015. Strategjia mbi Komunitetin Rom përfshin shumë fusha të gjera si arsimimi dhe trajnimi, trashëgimia kulturore dhe familja, punësimi, varfëria dhe mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor dhe strehimi, si dhe rendi publik, çështjet e drejtësisë dhe administratës civile. Sidoqoftë, zbatimi i kësaj strategjie është kritikuar për ngadalësinë e tij dhe kjo për shkak të burimeve njerëzore dhe financiare të pamjaftueshme por edhe koordinimit të papërshtatshëm institucional në nivel lokal dhe kombëtar si dhe për shkak të të metave në mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit.

Nëpërmjet këtij raporti, koalicioni i shoqërisë civile shqiptare, i ngritur posaçërisht për këtë qëllim, synon të vlerësojë zhvillimet politike kombëtare dhe ndikimin lokal të iniciativave që nxisin integrimin e romëve dhe nëpërmjet rsteve studimore të shpjegoje përse dhe në ç'nivel masa të caktuara të ndërmarra nga qeveria kanë qenë të suksesshme apo jo. Gjithashtu ai formulon rekomandime mbi mënyrën e përmirësimit të zbatimit të dokumenteve të mësipërme strategjike.

Kërkesat strukturore

Institucionet qeveritare qendrore dhe lokale

Sekretariati Teknik për Romet është krijuar pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në vitin 2004. Përveç kësaj, në vitin 2010 është krijuar një grup pune ndërministror për romët. Organizatat joqeveritare rome janë ftuar për të marrë pjesë në grupin e punës pa status vendimmarrjeje. Në terma praktike, roli i këtij grupi pune është më shumë ndarja e informacioneve dhe nxitja e koordinimit midis të gjitha ministrive përkatëse. Sekretariatit Teknik i mungon autoriteti i nevojshëm për të koordinuar

politikat midis ministrive dhe për të ndikuar tek autoritetet që kryejnë menaxhimin e fondeve të BE-së. Propozimi për ta shndërruar atë në një agjenci kombëtare është objekt diskutimi.

Në nivel vendor, një Komitet Koordinimi për Programimin, Vlerësimin dhe Koordinimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale është krijuar në secilin Këshill Qarku.¹ Përveç kësaj, një grup teknik për çështjet rome është krijuar në Këshillat e Qarqeve, i përbërë nga përfaqësues të të gjitha njësive administrative që kanë banorë romë, përfaqësues të Drejtorive Rajonale të varur nga pushteti qendror, përfaqësues të Organizatave Jo Qeveritare rome dhe të OJQ-ve të tjera lokale që lidhen me këtë çështje. Të gjitha strukturat e mësipërme institucionale në nivel lokal janë të përfshira më shumë në koordinimin e masave për zgjidhjen rst pas rasti të shqetësimeve të komunitetit rom sesa në formulimin e politikave, vlerësimin dhe monitorimin e tyre.

Mospërputhjet

Ekziston një numër shumë i madh dokumentesh strategjike lidhur me përfshirjen sociale, çështjet gjinore, çështjet e fëmijëve dhe të trafikimit, që përmbajnë objektiva dhe masa në lidhje me komunitetin rom, gratë rome dhe fëmijët romë. Ndërkohë, ekzistojnë dokumente dhe plane veprimi që lidhen në mënyrë specifike me komunitetin rom. Numri i madh i strukturave përkatëse institucionale është gjithashtu pasqyrim i kësaj "shumëllojshmërie" dokumentesh strategjike. Shume shpesh nisma të tilla ndikohen nga kriteret e harmonizimit të përfshira në marrëveshjen e stabilizim asociimit. Në këtë aspekt, është e nevojshme një qasje e njësuar në rradhë të parë nga vetë institucionet e Bashkimit Europian, në përputhje me "madhësinë", kontekstin dhe mundësitë shqiptare, dhe, më pas, një vendimmarrje më e vëmendshme për efektivitetin dhe efikasitetin e vendimeve që ata marrin në lidhje me dokumentet strategjike dhe strukturat institucionale përkatëse.

Financimi i BE-së

Shqipëria është inkurajuar nga Bashkimi Europian për të përdorur optimalisht instrumentet financiare, si për shembull instrumentet për para-aderimin, në përpjekjet për të arritur përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Në përgjithësi përfaqësuesit e komunitetit rom nuk ftohen për të marrë pjesë në mënyrë aktive në programimin e këtyre burimeve financiare. Opinioni i përgjithshëm i romëve është se pjesa më e madhe e këtij financimi adreson mbështetjen institucionale dhe jo nevojat e tyre reale në lidhje me zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

Anti-Diskriminimi

Regjistrimi dhe kartat e identitetit

Nga burime të ndryshme, popullsia rome në Shqipëri është llogaritur në 1300-120000 banorë. Ishte parashikuar që numri real të përcaktohej përfundimisht nëpërmjet Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 por rezultatet përfundimtare të deklaruara nga INSTAT-i treguan se komuniteti rom në Shqipëri përfaqëson vetëm 0.3% të popullsisë së përgjithshme (që i korrespondon më pak se 8500 personave).

Në lidhje me regjistrimin e romëve nga zyrat vendore të gjendjes civile, është bërë njëfarë progresi nëpërmjet disa ndryshimeve të legjislacionit ekzistues që e lehtëson regjistrimin. Në bazë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave të muajit dhjetor 2008, rreth 5000 romë morën kartat e tyre të identitetit pa pagesë.

Anti-Diskriminimi dhe Racizmi

Anti-diskriminimi është përmirësuar ndjeshëm në Shqipëri në aspektin ligjor dhe institucional. Në vitin 2010, u miratua nga Parlamenti Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje të plotë me katër direktivat kryesore europiane përkatëse. Rezultati i menjëhershëm pozitiv i miratimit të këtij ligji ishte ngritja e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ka shume pak të dhëna mbi mënyrën si komuniteti Rom

¹ Qeverisja vendore shqiptare realizohet nëpërmjet Këshillave të Qarkut, Bashkive dhe Komunave.

përfiton nga zbatimi i ligjit kundër diskriminimit. Avokati i Popullit i sapoemëruar ka marrë përsipër një rol proaktiv mbi incidentet e 45 familjeve romë në Tiranë në shkurt të vitit 2011.² Megjithatë, deri më sot nuk ka prova për një zgjidhje përfundimtare për këtë rast, duke përfshirë strehimin, masat e duhura për hetimin e incidenteve, si dhe identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Diskriminimi institucional

Institucionet qeveritare nuk kanë arritur ende të sigurojnë të dhëna të sakta statistikore për komunitetin rom dhe ky fakt përfaqëson një shembull të rëndësishëm të diskriminimit institucional ndaj komunitetit rom. Përveç kësaj, mungon mbledhja e të dhënave, raportimi dhe menaxhimi efikas i planit kombëtar të veprimit për komunitetin rom dhe nuk ka asnjë të dhënë për shpërndarjen e burimeve financiare në nivel vendor dhe qendror për çështjet e anti-diskriminimit. Institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore nuk janë proaktive për frenimin e diskriminimit dhe hetimin në lidhje me incidentet.

Institucioni i Anti-Diskriminimit

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi është fokusuar në tre funksione kryesore: (i) Mbështetja e viktimave të diskriminimit përmes shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, vendosjes së sanksioneve administrative dhe përfaqësimi i ankuesve në gjykatë për çështjet civile; (ii) Monitorimi i zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe (iii) Përgatitja e raporteve për çështjet e anti-diskriminimit, propozime për përmirësime në kuadrin ligjor dhe zhvillimi i fushatave sensibilizuese. Megjithatë kjo ka qenë periudha fillestare e aktivitetit të këtij institucioni, Komisioneri duket se nuk i kushton rëndësinë e duhur ankesave dhe hetimeve për çështjet e paraqitura. Kjo lidhet pjesërisht me kapacitetet e pakta të Zyrës së tij dhe ndoshta edhe me disa presione politike. Përveç kësaj, komuniteti rom nuk ka njohuri të mjaftueshme rreth ligjit të ri në lidhje me të drejtat e tij dhe procedurat që ato duhet të n ndjekin.

Direktivat e BE-së mbi Çështjet Raciale dhe Ankesat

Në legjislacionin shqiptar nuk ka boshllëqe të dukshme në lidhje me Direktivat e BE-së mbi Çështjet Raciale. Strategjitë ekzistuese kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale të përgatitura nga institucionet shtetërore përmbajnë edhe komponente të përfshirjes sociale. Ligji i anti-diskriminimit konfirmon të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente dhe depozitimin e kallzimeve për ndjekje penale. Deri tani nuk janë raportuar raste të diskriminimit të paraqitura për gjykim në gjykatat vendore apo në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Numri shumë i vogël i ankesave konfirmon ndërgjegjësimin e pamjaftueshëm të komunitetit të rom mbi të drejtën e tyre për ankimim dhe, gjithashtu, nevojën e madhe që ato kanë për ndihmë ligjore në rast diskriminimi.

Niveli Arsimit

Romët janë ndër komunitetet me nivelin më të ulët arsimor në Shqipëri. Perceptimi i përgjithshëm është se krahasimi midis nivelit arsimor të romëve dhe pjesës tjetër të popullsisë na tregon në mënyrë të pashmangshme faktin se hendeku midis dy grupeve është shumë i madh. Numri i fëmijëve romë që përfundojnë arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm të përgjithshëm rrjedhimisht është shumë i vogël. Numri i fëmijëve romë të regjistruar në sistemin e arsimit profesional dhe në arsimin e lartë mbetet i papërfillshëm. Mos-regjistrimi, mos-frekuentimi ose frekuentimi i parregullt i procesit mësimor dhe braktisja e shkollës janë dukuri tipike për fëmijët romë. Përveç kësaj, ekziston një mungesë e informacioneve të mjaftueshme statistikore dhe nuk është i mundur as sigurimi i të dhënave standarde mbi arsimimin e romëve dhe as përcaktimi i treguesve të qartë të lidhura me arsimin e tyre, që mund të krijojnë kushte për monitorimin e nivelit të përmbushjes së tyre.

Varfëria ekstreme është konsideruar si pengesa kryesore ndaj arsimimit. Interesimi shumë i pakët i prindërve romë, kryesisht për shkak të gjendjes ekonomike të familjeve romë, migrimit, aksesit në shkollë, trajtimit

2 Familjet romë u dëbuan me forcë nga disa qytetarë nga vendbanimet e tyre afër stacionit të trenit të qytetit të Tiranës. Këta Romë janë asistuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht në lidhje me ndjekjen gjyqësore të çështjes.

diskriminues të fëmijëve romë nga shokët e tyre jo romë dhe nga mësuesit, dhe traditat kulturore romë janë pengesa të tjera të rëndësishme për arsimimin e romëve.

Punësimi

Punësimi / papunësia është shqetësimi kryesor i komunitetit rom në Shqipëri, gjë që lidhet drejtpërdrejt me varfërinë e skajshme të familjeve romë. Varfëria e tyre në rritje krijon një rreth vicioz për ta: sa më të varfër bëhen, aq më e vështirë është për ta që të gjejnë punësim formal dhe informal. Shumë nga romët nuk janë në gjendje të gjejnë punë për shkak të mungesës së aftësive profesionale, mundësive të kufizuara për punësim pas ndryshimeve strukturore të ekonomisë, mospërshtatjes me nevojat e reja të tregut të punës, diskriminimit nga punëdhënësit dhe nga mungesa e politikave të posacme të hartuara për të trajtuar çështjen e papunësisë së romëve.

Qeveria siguron ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie për disa familje të varfra dhe për persona të papunë. Aktualisht, një numër shumë i vogël i romëve përfitojnë mbështetje të tilla financiare dhe shumë prej tyre janë të përjashtuar nga marrja e ndihmës ekonomike ose nga marrja e kësaj asistence për aq kohë sa është e nevojshme. Kjo ndodh kryesisht për shkak të disa kriterëve të përcaktuara nga institucionet shtetërore, të cilat nuk janë të harmonizuara siç duhet me realitetin e komunitetit rom.

Kujdesi Shëndetësor

Ndërsa në Shqipëri është e vështirë për të gjetur të dhëna zyrtare mbi statusin e kujdesit shëndetësor të komunitetit rom dhe aksesin e tyre në kujdesin shëndetësor, është e sigurt se, gjatë periudhës së tranzicionit, gjendja shëndetësore e romëve është përkeqësuar në një masë më të madhe se sa pjesa tjetër e popullsisë.

Romët ndihen të diskriminuar haptas nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore në krahasim me popullsinë jo romë. Kjo nuk lidhet vetëm me shqetësimet e përbashkëta të shoqërisë shqiptare në lidhje me mitmarrjen nga mjekët apo infermierët, por edhe me shembuj të shumtë të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në lidhje me trajtimin e papërshtatshëm nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, pengesat e komunikimit, shkeljen e të drejtave mbi kujdesin shëndetësor, që të gjitha së bashku i bëjnë sistemin shëndetësor dhe qendrat e kujdesit shëndetësor vende jo miqësore për romët. Diskriminimi shkurajon komunitetin rom që të adresojë menjëherë problemet shëndetësore dhe ndikon negativisht tek përpjekjet e mëdha të bëra nga OJQ-të për rritjen e ndërgjegjësimit për të siguruar pjesëmarrjen e rregullt të këtij komuniteti në kontrolle shëndetësore për të parandaluar sëmundjet dhe mbrojtur fëmijët e tyre.

Një nga shqetësimet kryesore të romëve është mungesa e librezës së sigurimit shëndetësor. Kjo lidhet kryesisht me faktorë të punësimit: shumë prej romëve ose janë të papunë, ose punojnë pa kontratë pune të vlefshme. Në të dyja rastet rezultati është se ata nuk paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kështu nuk kanë të drejtë për përfitime. Romët që jetojnë me të ardhura të ulëta nuk janë në gjendje të përballojnë pagesat për sigurim shëndetësor. Përveç kësaj, shumë prej këtyre individëve nuk janë të informuar mbi procedurat që duhet të ndiqen për të marrë një librezë sigurimi shëndetësor. Kështu, romët përballen me një pengesë të pakapërcyeshme në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor: kostoja e lartë e shërbimeve mjekësore dhe barnave janë të vështira për tu përballuar prej familjeve romë. Si rezultat, romët në përgjithësi janë tepër neglizhentë në lidhje me shëndetin e tyre dhe kërkojnë ndihmë mjekësore vetëm në një fazë shumë të avancuar të sëmundjes. Shumë shpesh në këto raste ata janë të detyruar të marrin hua para nga romë të tjerë, gjë që ndiqet nga një *efekt domino* i borxhit, duke çuar drejt shkatërrimit total ekonomik. Mbështetja nga OJQ-të vendase dhe ndërkombëtare përfaqëson të vetmen shpresë për ta në rast të ndonjë sëmundjeje së rëndë.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen falas për fëmijët. Megjithatë, shumë prindër romë kërkojnë trajtim mjekësor për fëmijët e tyre vetëm në një fazë të avancuar të sëmundjes. Përveç kësaj, shumica e prindërve romë nuk mund të përballojnë pagesën për një sërë medikamentesh ose analizash të veçanta

mjekësore, që nuk ofrohen nga institucionet shëndetësore publike për arsye të ndryshme, por megjithatë kërkohen nga stafi mjekësor. Kjo lidhet, veçanërisht, me kujdesin spitalor.

Strehimi

Sipas studimit tonë, mungesa e sstrehimit, riparimi i shtëpive, legalizimi , çështjet e titujve të pronësisë dhe infrastruktura e dobët janë konsideruar nga komuniteti rom si disa nga shqetësimet më kryesore që duhen zgjidhur. Mungesa e furnizimit me ujë është shumë e shpeshtë, veçanërisht për familjet rome që jetojnë në vendbanime të veçuara në periferi të qyteteve ose larg zonave urbane. E njëjta gjendje është edhe për kushtet e higjienës. Shumë prej familjeve rome jetojnë në zona pa rrugë dhe nëse i kanë rrugët ato janë në gjendje shumë të keqe ose të pashtuara . Ata kanë energji elektrike në shtëpi por nuk ka ndriçim publik në zonat ku jetojnë. Të gjitha këto kushte kanë ndikim të hapur negativ në gjendjen e tyre shëndetësore dhe infeksionet janë shumë të shpeshta, veçanërisht për fëmijët. Përveç kësaj, për shkak të varfërisë, shumë familje rome që jetojnë në Shqipëri kanë migruar brenda vendit dhe familje të tjera janë kthyer nga emigracioni, kryesisht nga Greqia, duke ngritur ndërtesa joformale në lagje të varfra dhe në kushte të varfërisë ekstreme, ku mungon infrastruktura bazë. Kjo ndarje fizike e migrantëve romë është një fenomen i përgjithshëm i dekadës së fundit që kufizon ndjeshëm mundësitë e tyre të integritit. Familjet rome janë pothuajse të përjashtuara nga programet sociale të strehimit. Pak prej tyre mund të përfitojnë nga programi i banesave sociale me kosto të ulët pasi shumica e romëve janë të papunë dhe /ose nuk kanë të ardhura të rregullta mujore, gjë që është kusht kryesor për financimin nga bankat. Në mënyrë të ngjashme, romët nuk janë konsideruar si një grup i synuar specifik në programin e banesave sociale me qira dhe kushtet e strehimit të romëve nuk janë trajtuar siç duhet: në statusin e strehimit nuk janë parashikuar familjet që jetojnë në lagjet e varfra, në kushtet sociale nuk janë përfshirë familjet rome, dhe në statusin ekonomik nuk janë parashikuar familjet pa asnje të ardhur. Si rezultat, duket fare qartë se programet sociale të strehimit trajtojnë probleme të strehimit të familjeve në nevojë në përgjithësi dhe nuk janë programe të dedikuara për familjet rome.

Bazuar në faktorët e mësipërm, ekziston një diskriminim i qartë ndaj komunitetit rom që shfaqet në kushtet shumë të vështira të banimit, veçimit në rritje, dëbimeve të dhunshme, si dhe në mungesën e titujve të pronësisë dhe përpjekjeve të pafinalizuara të legalizimit. Si rezultat, perceptimi i përgjithshëm i romëve është se askush nuk angazhohet seriozisht për zgjidhjen e problemeve të tyre të strehimit.

REKOMANDIME

Rishikimi i Qasjes Strategjike

Është shumë e rëndësishme të kuptohet që Komuniteti Rom vazhdon të përfaqësojë pjesën më të varfër të popullsisë shqiptare dhe minoritetin më të brishtë në vend. Si rezultat, nevojat prioritare të romëve nuk janë të lidhura vetëm me disa çështje të përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe/ose me disa çështje të të drejtave të minoriteteve. Po ashtu, progresi nuk duhet të matet vetëm me numrin e dokumenteve strategjike të përgatitur nga institucionet shtetërore, me nivelin e harmonizimit të disa Ligjeve specifike me standardet përkatëse të BE-së, përmirësimin e kuadrit rregullator përkatës, promovimin e hapjes së qendrave kulturore dhe ngritjen e disa institucioneve të anti-diskriminimit. Komuniteti rom ka nevojë të integrohet më mirë në shoqërinë shqiptare nëpërmjet ofrimit të niveleve të pranueshme të arsimit, krijimit të kushteve të përshtatshme të jetesës dhe trajtimit të barabartë nga ana e shërbimeve publike. Ndërkohë që të mbështesësh komunitetin rom do të thotë në rradhë të parë të zgjidhësh sa më shpejt këto probleme, perceptimi i përgjithshëm është se deri tani vëmendja e të gjithë institucioneve lokale, qendrore dhe ndërkombëtare është fokusuar më shumë në çështje të anti-diskriminimit sesa në nevojat reale të këtij komuniteti.

Kështu, rekomandohet ri-vlerësimi, si në nivel lokal ashtu edhe atë global, i qasjes së përfshirjes së romëve, duke kaluar nga një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut në një qasje të bazuar mbi zhvillimin. Veprimet e aktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë duhet të fokusohen më shumë në nevojat reale të komunitetit rom, duke patur në konsideratë që përfshirja e romëve është para së gjithash një çështje zhvillimi për të zbutur varfërinë, rritur punësimin e tyre, luftuar kundër analfabetizmit dhe përmirësuar kushtet e jetesës.

Pika e (ri) fillimit: Gjendja e komunitetit rom dhe veprimet prioritare

Megjithë disa përpjekje të bëra dhe financimin e vazhdueshëm, pas më shumë se 20 vitesh të tranzicionit post-komunist, institucionet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare kanë dështuar në krijimin e një baze të plotë të të dhënave të komunitetit rom në Shqipëri. Në mungesë të informacionit real mbi gjendjen e romëve, është e pamundur të formulohen politika të përshtatshme, të miratohen strategji efektive dhe të zbatohen me efektivitet masa prioritare. Kjo i bën gjithashtu jo efçente përpjekjet për financim për zgjidhjen e problemeve të komunitetit rom. Si rezultat, rekomandohet me përparësi rifillimi i përpjekjeve për mbledhjen e informacionit. Një regjistrim specifik i komunitetit rom duket tashmë se është i domosdoshëm dhe i pashmangshëm. Po ashtu, nevojitet ri-përcaktimi i programeve statistikore në Ministrinë e linjës dhe INSTAT për të vendosur një sistem të plotë të grumbullimit të të dhënave, si dhe të vënies periodikisht në dispozicion të të dhënave të besueshme mbi komunitetin rom.

Shumë masa të miratuara nga Qeveria në interes të zgjidhjes së shqetësimeve të komunitetit rom janë të shpërndara në disa Ligje, Vendime të Qeverisë dhe/ ose Direktiva Ministrorë dhe shumë shpesh komuniteti rom nuk përfiton prej tyre në praktikë. Në të njëjtën kohë, nevoja të tjera të rëndësishme të komunitetit rom në lidhje me arsimimin, kujdesin shëndetësor, punësimin dhe strehimin nuk konsiderohen nga kuadri ligjor dhe rregullues ekzistues që lidhen me sektorët përkatës të tyre. Rekomandohet me përparësi formulimi i një Ligji-ombrellë për përfshirjen e romëve, nëpërmjet një procesi të gjerë pjesëmarrës të përfaqësuesve romë dhe të gjithë OJQ-ve përkatëse, i cili përfshin edhe masat përkatëse mbi shqetësimet e komunitetit rom.

Rekomandohet gjithashtu miratimi i një Plani Veprimi ombrellë mbi Integrimin e Komunitetit Rom për periudhën 2013-2020. Tregues sa më realistë të arritjeve dhe objektivave duhet të përfshihen në këtë Plan Veprimi, me synim që të hidhen bazat për monitorimin efektiv dhe vlerësimin e progresit dhe për një ndikimin real të kontributit të Qeverisë.

Forcimi i Institucioneve Shtetërore

Sekretariatit Teknik i mungon autoriteti i nevojshëm për të koordinuar politikat dhe veprimet ndërmjet ministrive për shkak të statusit të tij aktual në kuadër të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Rekomandohet për ta shndërruar këtë Sekretariat në një Agjenci Kombëtare në varësi të Kryeministrit. Përveç kësaj, është e nevojshme të unifikohen funksionet dhe strukturat e të gjitha njësive dhe organeve përgjegjëse të romëve, fëmijëve, grave, personave me aftësi të kufizuara, si dhe për çështje të trafikimit të qenieve njerëzore, në të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore. Rekomandohet që të gjithë këta aktorë të përfshihen nën ombrellën e Njësive të Përfshirjes Sociale për grupet/ kategoritë kryesore të mbrojtura. Është e nevojshme të krijohet së pari kapitali njerëzor për të sjellë autoritetin e nevojshëm, pasuar më tej nga procedurat detyruese dhe kontributet financiare nga buxheti i shtetit.

Efektiviteti i institucioneve që trajtojnë çështje të anti-diskriminimit mbetet në nivel të ulët. Është e nevojshme që Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të zbatojë më mirë funksionet e veta duke demonstruar vendosmëri dhe pavarësi në trajtimin e ankesave në mënyrë që të fitojë besimin e komunitetit rom, si dhe për të inkurajuar depozitimin e ankesave të tyre. Po ashtu, është e nevojshme që të rriten kapacitetet e kësaj Zyre, veçanërisht në aspektin e metodologjive për përgatitjen e raporteve të monitorimit mbi zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit. Përveç kësaj, është i domosdoshëm sigurimi i burimeve të nevojshme financiare në mënyrë që kjo zyrë të kryejë funksionet e veta mbi bazë të përgjegjësive të përcaktuara në ligj.

Vendosja e një Kuadri Përgjegjshmërie

Me sa duket, pjesa më e madhe e mbështetjes financiare të brendshme dhe të huaj për romët është mbështetje e llojit *soft* që lidhet me konsolidimin e komunitetit rom nëpërmjet veprimtarive trajnuese dhe fushatave publike ndërgjegjësuese, veprimtarive anti-diskriminuese, forcimit të identitetit kulturor të romëve dhe mbështetje për qendrat kulturore, harmonizimit të legjislacioni në lidhje me standardet e të drejtave të njeriut në interes të forcimit të kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe lokal. Në të vërtetë, të gjitha çështjet e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe kanë nevojë për vëmendje të mëtejshme. Ndërkohë, mbështetja e llojit *hard* që ka të bëjë me nevojat konkrete të uljes së varfërisë, arsimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe çështje të strehimit, kufizohet kryesisht në programet e ndihmës humanitare, projektet pilot të kopshteve dhe shkollave, projekte të izoluara të rehabilitimit të shtëpive etj. Po ashtu, nuk ka asnjë informacion mbi efektivitetin e shpenzimeve, asnjë informacion mbi treguesit e arritjeve, si dhe përgjegjshmëri të ulët të financimeve të huaja.

Në fakt, është e nevojshme që përpjekjet të përqendrohen më shumë në mbështetjen e llojit *fortë* për zgjidhjen e shqetësimeve prioritare të romëve, për më shumë angazhim transparent dhe shpenzime të efektshme në lidhje me këtë komunitet. Kjo nënkupton ndërhyrje të plota transparente dhe raportime përkatëse nga të gjitha palët e interesuara. Kjo nënkupton, gjithashtu, shfrytëzimin e kujdesshëm të burimeve të ndryshme dhe përdorimin e strategjive multifunksionale, duke përfshirë burimet e brendshme financiare për zhvillimin, Investimet e Huaja Direkte, mekanizmat e financimit publik – privat etj. Përveç kësaj, duke pasur parasysh numrin e madh të agjencive të donatorëve ndërkombëtarë të interesuara për mbështetjen e çështjeve të komunitetit rom, rekomandohet krijimi i një Grupi Pune të veçantë të Donatorëve për çështjet rome sipas modelit ekzistues të koordinimit të donatorëve të vendosur nga Departamenti i Strategjive dhe Koordinimit të Donatorëve në Këshillin e Ministrave.

Rritja e Nivelit Arsimor

Me qëllim që të rritet niveli i arsimit, rekomandohet të fillohet nga përmirësimi i mundësive që në fëmijërinë e hershme dhe i rritjes së frekuentimit të arsimit parashkollor nëpërmjet planifikimit dhe zgjerimit të mëtejshëm të infrastrukturave parashkollore kryesore dhe të integruara, me synimin e përfshirjes të të gjithë fëmijëve romë në këtë nivel arsimor. Rekomandohet, gjithashtu, rritja e motivimit të fëmijëve romë (si dhe të prindërve të tyre) për ndjekjen e arsimit parashkollor nëpërmjet garantimit të transportit, veshjeve dhe mbështetjes me ushqim.

Është e nevojshme që prindërit së bashku me administratorët e shkollave dhe mësuesit të mbështesin dhe inkurajojnë fëmijët romë të frekuentojnë shkollën, duke i ndihmuar ata të kapërcejnë prapambetjen, duke i angazhuar në programe të veçanta apo duke i dhënë ndihmë plotësuese, derisa të përfundojnë arsimin e tyre bazë. Nxënës të talentuar romë nga familjet e varfra mund të mbështeten me bursa të ofruara posaçërisht për të qenë në gjendje të vazhdojnë studimet e tyre të mesme dhe universitare.

Në shkollat e arsimit bazë që ndiqen nga nxënësit romë mund të futen programe shtesë në mënyrë që nxënësit romë të mund të studiojnë pas mësimit në mjediset e shkollës, të ndihmuar nga mësuesit. Rekomandohet, gjithashtu, të përgjithësohen më tej shembujt e mirë ekzistues nga programet e shancit të dytë, që kanë mbështetur fëmijë romë me rezultate të dobta ose përsëritës. Për inkurajimin e të rinjve që të rikthehen në shkollë apo për parandalimin e mëtejshëm të ngeljes në klasë të nxënësve mund të adoptohet një qasje më sistematike e financuar nga shteti apo nga donatorët, nëpërmjet programesh të fokusuar në komunitete të vogla të të rinjve romë apo nëpërmjet qendrave të trajtimit të “ngelësve”, organizimit të mësimëve me kohë të pjeshme, si dhe programeve të mbikëqyruara të kurseve profesionale.

Forcimi i identitetit kulturor të romëve mbetet një objektivi që ka nevojë për vëmendje dhe mbështetje të mëtejshme pasi kjo ndihmon për të arritur një integrim më të mirë të nxënësve romë. Rekomandohet, gjithashtu, përfshirja në sistemin arsimor bazë e disa aktiviteteve përtej programit mësimor që lidhen me historinë, kulturën, traditat dhe gjuhën e romëve në Shqipëri.

Punësimi – Shqetësimi Kryesor

Për të ndihmuar romët të integrohen në tregun e punës, një rëndësi parësore ka rritja e mundësive të punësimit nëpërmjet arsimit dhe shkollimit të rregullt të tyre. Rekomandohet gjithashtu që të ofrohen kurse trajnimi falas për përmirësimin e aftësive të tyre në përgjigje të kërkesave në ndryshim të tregut të punës. Duhet të formulohen dhe zbatohen politika dhe strategji trajnimi specifike, që bazohen në analiza të veçanta të nevojave të romëve për trajnim, të cilat duhet të konsiderohen edhe nga qendrat ekzistuese të formimit profesional. Përveç kësaj, rekomandohet që këto masa të plotësohen me përpjekjet për të kombinuar programet e trajnimit me projekte të punëve publike dhe të bizneseve sociale, duke nxitur partneritetin publik-privat dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të komunitetit rom. Gjithashtu mund të aplikohen skema kredie për të mbështetur veçanërisht romët që kthehen nga emigracioni.

Rekomandohet hartimi i programeve të nxitjes së punësimit që synojnë në mënyrë specifike popullsinë rome. Po ashtu, Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të ofrojë ndihmë dhe lehtësi që Romët e papunë të përfitojnë nga programe të tilla. Ndërkohë, rekomandohet zbatimi në praktikë i më shumë aktiviteteve sensibilizuese për popullsinë rome me informacion për domosdoshmërinë e regjistrimit të tyre si punëkërkues, duke treguar se deri në ç’ masë regjistrimi ndikon në çështje të tjera të rëndësishme për ta, sic janë përfitimet e ndihmës sociale dhe kujdesin shëndetësor.

Duke pasur parasysh se disa kritere të përshtatshmërisë të përcaktuara nga institucionet shtetërore nuk janë në harmoninë e duhur me realitetin e romëve dhe shumë familje rome në nevojë nuk mund ti plotësojnë ato, rekomandohet hartimi i disa kritereve të tjera në përputhje specifike me realitetin e komunitetit rom dhe që nuk i penalizon romët nga përfitimi i kësaj ndihme.

Kujdesi Shëndetësor i Pamjaftueshëm

Për të trajtuar çështjet e kujdesit shëndetësor të romëve është i nevojshëm hartimi i politikave shtetërore të veçanta për sa i përket dhënies së librezave të sigurimeve shëndetësore. Rekomandohet dhënia e librezave të tilla falas për një grup të përzgjedhur romësh, që nuk janë në gjendje të përballojnë pagesën përkatëse.

Po kështu, rekomandohet organizimi i vizitave të rregullta në lokalitetet rome dhe lagjet e varfra, nëpërmjet njësive të lëvizshme mjekësore që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor për fëmijët, nënat shtatzëna dhe nënat e reja, si dhe për të moshuarit. Rekomandohen masa të veçanta për të edukuar dhe rritur ndërgjegjësimin e komuniteteve rome për çështje themelore të shëndetit, duke ssynuar në vecanti prindërit, gratë dhe nënat e reja, si dhe fëmijët në shkolla.

Rekomandime të tjera të veçanta për tu konsideruar janë edhe ato që lidhen me diskriminimin ndaj kujdesit shëndetësor, duke garantuar vënien në dispozicion të romëve të disa mekanizmave efektivë për adresimin e shkeljeve të të drejtave për kujdes shëndetësor, ekzistencën e një platforme për mbledhjen e komenteve/ankimeve nga popullsia Rome për shërbimet dhe politikat shëndetësore dhe programet e tyre përkatëse, marrjen në konsideratë të këtyre komenteve gjatë formulimit të politikave dhe masave të tilla dhe adoptimin e tyre për nevojat e komunitetit rom; si dhe garantimin e pjesëmarrjes efektive të romëve në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe masave shëndetësore.

Strehimi – Shqetësimi i Dytë Kryesor

Rekomandohet të fillohet me zgjidhjen e nevojave për strehim të romëve nëpërmjet një vlerësimi të përgjithshëm teknik dhe të pavarur të kushteve të banimit të romëve, duke përfshirë në veçanti familjet e pastreha rome, nevojat për rehabilitim të banesave, si dhe familjet rome në lagjet e varfra. Censusi i vitit 2011 ka qenë një shans i humbur për institucionet shtetërore dhe donatorët ndërkombëtarë për ta bërë këtë vlerësim.

Rekomandohet, gjithashtu, ngritja e Fondit të Strehimit të Romëve, që duhet të financojë, koordinojë dhe menaxhojë të gjitha masat e përealizuara në lidhje me shqetësimet e romëve për strehim.

Rritja e Shkallës së Pjesëmarrjes dhe e Ndërgjegjesimit të Romëve

Duke marrë parasysh nivelin e ulët të pjesëmarrjes së romëve në procesin e politikëbërjes, rekomandohet diskutimi në nivel komuniteti i dokumenteve strategjike shtetërore dhe i masave prioritare, nëpërmjet tryezave rajonale me pjesëmarrjen e liderëve të bashkësisë rome dhe përfaqësuesve të OJQ-ve lokale të romëve. Pjesëmarrja e romëve është themelore para së gjithash në programimin e masave dhe monitorimin e progresit në nivel komuniteti. Rrjedhimisht, rekomandohet që OJQ-të (përfshirë OJQ-të rome) dhe institucionet qeveritare të konsiderojnë ndërmarrjen e veprimeve që nxisin dialogun në nivel lokal si dhe të vënë aktivitetet e tyre në dispozicion të vlerësimit kritik të përfituesve të mundshëm.

Zbatimi i suksesshëm i politikave të integritit të komunitetit rom kërkon një perceptim të përbashkët të komunitetit rom dhe jo-rom mbi përfitimet e përbashkëta të përfshirjes së romëve, që mund të nxitet nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse kombëtare dhe lokale. Në këtë drejtim, ka nevojë gjithashtu për të nxitur fushata ndërgjegjësimi për anti-diskriminimin, me fokus të veçantë tek të drejtat individuale të përcaktuara me ligj.

Studentët universitarë romë duhet të nxiten e lehtësohen për t'u organizuar në Klube të Studentëve Romë në mënyrë që të shndërrohen në organe përfaqësuese intelektuale rome për të mbrojtur të drejtat e romëve, që të flasin dhe të jenë mbështetës të këtij komuniteti, duke u bërë shembuj të shkëlqyer për t'u ndjekur nga të gjithë anëtarët e komunitetit rom.

SHKURTIME

KSH	Kushtetuta e Shqipërisë
KIE	Këshilli i Europës
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
SHC	Shoqëria Civile
PVDR	Plani i Veprimit i Dekadës Rome
NE	Ndihma Ekonomike
KE	Komisioni European
BE	Bashkimi European
QSH	Qeveria Shqipëtare
LSSH	Libreza e Sigurimit Shëndetësor
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit
CU	Cikli i Ulët
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SKIR	Strategjia Kombëtare për Integrimin e Komunitetit Rom
SKPKJKR	Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Komunitetit Rom
NJKP	Njësia e Koordinimit të Programit
RP	Raporti i Progresit
DRA	Drejtoria Rajonale e Arsimit
ZRP	Zyra Rajonale e Punësimit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
ST	Sekretariati Teknik
CL	Cikli i Lartë
UN	Kombet e Bashkuara
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
TP	Trajnimi Profesional
BB	Banka Botërore
GP	Grupi i Punës

Komuniteti rom në shqipëri

Romët jetojnë pothuajse në të gjitha zonat e Shqipërisë, por komunitetet më të shumëshme janë vendosur në pjesën qendrore dhe juglindore të vendit ose në qytetet e mëdha, kryesisht në grupe të ndara në rrethinat e qyteteve, ose në fshatra të afërta të qyteteve përkatëse. Ato janë grupuar në katër fise rome – *Meckars, Kurtofs, Kabuzis dhe Cergars*, të cilët kanë profesionet e tyre të veçanta, pak a shumë të dallueshme nga njëra-tjetra: fisi *Meçkar* është përfshirë kryesisht në bujqësi dhe blegtori, fisi *Kurtof* është i prirur për tregti të vogël dhe zejtari, fisi *Kabuzi* janë kryesisht muzikantë dhe artizanë, burrat e fisit *Cergar* janë udhëtarë dhe tregtarë, ndërsa gratë e tyre janë zakonisht fallxhore.

Romët në Shqipëri nuk kanë përfaqësim politik në formën e ndonjë partie politike. Megjithatë, menjëherë pas vitit 1990, u themeluan tri Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) për të përfaqësuar romët në nivel kombëtar: Unioni Demokratik i Romëve në Shqipëri Amaro Dives, Rromani Baxt dhe Amaro Drom. Më pas, u themeluan OJQ të tjera dhe sot ekzistojnë gati 20 prej tyre.

Romët nuk njihen ligjërisht si minoritet i veçantë në Shqipëri; vetëm komunitetet etnike me shtete ekzistuese janë pranuar si të tilla, gjë që nuk përbën rastin e romëve, të cilët nuk kanë ndonjë shtet mbështetës. Kushtetuta e Shqipërisë (KSH) e vitit 1998 u dha romëve statusin e një minoriteti etnolingistik. Megjithatë, KSH i trajton parimet bazë të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.³ Neni 3 sanksionon se bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me minoritetet është themeli i shtetit, i cili nga ana e tij ka për detyrë ti respektojë dhe mbrojë ata. Neni 15 shprehet se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme dhe që qëndrojnë në themel të rendit juridik. Neni 18 përcakton se askush nuk mund të diskriminohet në mënyrë të padrejtë për arsye që lidhen me gjininë, racën, fenë, origjinën etnike, gjuhën, bindjet politike, fetare apo filozofike, kushtet ekonomike, arsimimin, statusin shoqëror ose trashëgiminë e të kaluarës. Së fundi, neni 20 u garanton minoriteteve ushtrimin e barabartë të të drejtave dhe lirive të tyre para ligjit. Ata kanë gjithashtu të drejtë të shprehen lirshëm, pa u penguar apo detyruar të shprehin përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare apo gjuhësore. Ky nen mbështet, gjithashtu, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, studimin apo mësimin në gjuhën e tyre amtare, si dhe anëtarësimin në organizata apo shoqata për mbrojtjen e interesit dhe identitetit të tyre.

Aktualisht, Shqipëria është pjesë e traktateve bazë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve. Në vitin 1991, ajo ratifikoi Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Politike dhe Civile, që i garanton minoriteteve etnike, kombëtare dhe fetare midis të drejtave politike dhe civile të drejtën për tu organizuar mbi bazën kulturore, fetare e gjuhësore. Në vitin 1996 Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Europës (KIE) për Mbrojtjen e e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, që garanton respektimin e të drejtave të minoriteteve mbi baza individuale. Gjatë po atij viti ajo ka ratifikuar, gjithashtu, Konventën e Bashkimit Europian (BE) për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues. Në shtator 1999 ajo ratifikoi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, e cila përmban disa klauzola specifike për minoritetet për sa i përket arsimimit në gjuhën e minoriteteve.

Shqipëria nuk ka një Strategji Kombëtare për Integrimin e Komunitetit Rom (SKIR). Megjithatë, Qeveria e Shqipërisë (QSH) ka marrë disa masa politike në mbështetje të Përfshirjes Sociale të Romëve. Miratimi në vitin 2003 i Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom (SKPKJKR)

3 Kushtetuta Shqiptare, tetor 1998.

2003-2013 ishte një nga vendimet më të rëndësishme për këtë çështje. Kjo strategji trajton fusha të gjera si edukimi dhe trajnimi, trashëgimia kulturore, familja, punësimi, varfëria dhe mbrojtja sociale, shëndeti publik dhe strehimi, si dhe rendi publik, drejtësia dhe administrata publike. Strategjia është vlerësuar veçanërisht për thellësinë dhe sensibilizimin për çështjet gjinore dhe të rinjve; megjithatë zbatimi i saj është kritikuar si i ngadaltë për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, koordinimit të pamjaftueshëm institucional në nivel kombëtar dhe vendor dhe të metave në mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit.⁴ Ky dokument u përgatit në konsultim me anëtarë të OJQ-ve romë. Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm i komunitetit rom është se ata nuk marrin pjesë në procesin e politikëbërjes të bashkisë/komunës së tyre dhe/ose të qeverisë qendrore.⁵ SKPKJKR u pasua nga miratimi i Planit të Veprimit të Dekadës Rome 2010-2015 (PVDR) në vitin 2010.

Pavarësisht nga zhvillimet e mësipërme ligjore dhe institucionale, komuniteti rom konsiderohet nga studime⁶ dhe raporte⁷ të ndryshme se përbën grupin më vulnerabël të minoriteteve në Shqipëri, i cili përballet me varfëri masive, marzhinalizim socio-ekonomik dhe diskriminim të shpeshtë, veçanërisht në arsim, mbrojtje sociale, shëndetësi, punësim dhe strehim. Kështu, niveli i varfërisë së romëve është dy herë më i lartë sesa tek shqiptarët etnikë, niveli i tyre i papunësisë është 3 herë më i lartë sesa mesatarja e vendit dhe të ardhurat për rreth 37% të familjeve romë janë më pak se 100\$/në muaj në krahasim me 2 për qind të familjeve jo-romë me të njëjtin nivel të ardhurash mujore. Kjo lidhet veçanërisht me rënien e standardeve të jetesës të komunitetit rom gjatë tranzicionit post-komunist, rënien dhe mbylljen e ndërmarrjeve shtetërore. Për shkak të mungesës të aftësive, nivelit të ulët arsimor dhe diskriminimit, romët kaluan nga një mirëqenie relative në varfëri ekstreme dhe ky komunitet është prekur nga tranzicioni më shumë sesa grupe të tjera të popullsisë.⁸ Si rezultat, rreth 87% e popullsisë romë është e pakënaqur ose shumë e pakënaqur me jetën e tyre aktuale në krahasim me 19% të popullsisë jo-romë dhe rreth 59% e romëve nuk kanë para të mjaftueshme për ushqim në krahasim me 4% të popullsisë jo-romë.⁹

Raporti monitorues i shoqërisë civile

Në përgjigje të Kuadrit të KE-së për SKIR, vendet candidate të BE-së që marrin pjesë në Dekadën e Përfshirjes Rome u ftuan të përditësonin SKIR dhe PVDR e tyre sipas Kuadrit të BE-së duke përfshirë shoqërisë civile sëbashku me organizatat romë në monitorimin e zbatimit të strategjive.

Nëpërmjet këtij raporti, koalicioni i shoqërisë civile shqiptare i krijuar për këtë qëllim, plotëson dhe paraqet informacion alternativ për raportet e paraqitura nga QSH për zbatimin e PVDR-së në bazë të disa të dhënave shtesë ndaj atyre zyrtare, të dhënave të përafërta kur nuk ka të dhëna zyrtare ose interpretimit alternativ të të dhënave të publikuara, duke synuar:

- vlerësimin e zhvillimeve të politikave kombëtare që ofrojnë të dhëna për punën e përgjithshme të institucioneve shtetërore, veçanërisht në lidhje me zbatimin e politikave gjatë vitit 2012;
- vlerësimin e impaktit lokal të nismave më të rëndësishme që nxisin integrimin e romëve;
- shpjegimin nëpërmjet rasteve studimore se përse dhe në ç'nivel disa masa qeveritare kanë qenë të suksesshme apo jo; dhe
- formulimin e rekomandimeve mbi mënyrën e përmirësimit të zbatimit të SKPKJKR dhe PVDR-së.

Informacioni është plotësuar nga diskutimet në tryeza debati dhe diskutimet në grupe të fokusuar me përfaqësues të komunitetit rom në rajonet e Tiranës, Lezhës, Fierit, Beratit, Elbasanit, Korçës dhe Gjirokastrës. Janë kontaktuar, gjithashtu, përfaqësues të Bashkive dhe Komunave përkatëse si dhe të Departamenteve Rajonale Arsimore (DRA), Zyrave Rajonale të Punësimit (ZRP) dhe Zyrave Rajonale të Shërbimit Social

4 Raport Progresi i KE-së, Shqipëria 2010.

5 OSFA, Studim Krahasues për Faktorët që Prekin Shkallën e Integritit të Komunitetit Rom në Shqipëri, rezultatet paraprake, 2011.

6 De Soto, et al., Romët dhe egjiptianët në Shqipëri – Nga Përfshirja Sociale në Përfshirjen Sociale, Banka Botërore, mars 2005.

7 Raport Progresi i KE-së, Shqipëria 2010.

8 De Soto, et al., Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri – Nga Përfshirja Sociale në Përfshirjen Sociale, Banka Botërore, mars 2005.

9 OSFA, Studim Krahasues për Faktorët që Prekin Shkallën e Integritit të Komunitetit Rom në Shqipëri, rezultatet paraprake, 2011.

Shtetëror. Më tej, është organizuar tryezë e rrumbullakët specifike me studentë universiteti nga komuniteti rom të regjistruar në universitete të ndryshme publike dhe private.

Mendimet e përfaqësuesve të komunitetit rom u mbledhën edhe nëpërmjet një anketimi kombëtar të realizuar në rajonet e Tiranës, Elbasanit, Korçës, Fierit, Beratit dhe Gjirokastrës, që përfaqësojnë komunitetet kryesore rome të Shqipërisë. Kampioni përfshinte 350 pyetësorë (shihni Shtojcën 1) të shpërndarë gjeografikisht sipas madhësisë relative të komunitetit rom.

Perspektiva europiane e shqipërisë

Shqipëria po merr pjesë në mënyrë aktive në dialogun e rregullt politik dhe ekonomik me BE-në sipas kuadrit të Procesit të Stabilizim-Asociimit. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë është nënshkruar në qershor të vitit 2006 dhe ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2009. Më pas, Shqipëria paraqiti aplikimin e saj për anëtarësim në BE më 28 prill 2009. Pas një kërkesë nga Këshilli, Komisioni Europian (KE) paraqiti Opinionin e tij për aplikimin e Shqipërisë në nëntor të vitit 2010. Në dhjetor 2010 Këshilli miratoi rekomandimet e Opinionit të Komisionit. Në konkluzionet e tij, Këshilli vërejtë se hapja e bisedimeve të anëtarësimit do të shqyrtohet nga Këshilli Europian, në përputhje me praktikën e krijuar, pasi Komisioni të ketë vlerësuar se vendi ka arritur shkallën e nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit.¹⁰

BE i ka ofruar Shqipërisë asistencë financiare të para-aderimit sipas Instrumentit për Asistencë Para-Aderimi (IPA). Ndihma financiare fokusohet në çështje të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme, Reformën në Administratën Publike, Transportin, Mjedisin dhe Ndryshimin Klimatik, Zhvillimin Social, Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Përveç kësaj, Shqipëria merr pjesë në menaxhimin dhe zbatimin e programeve ndërkufitare të BE-së në Ballkanin Perëndimor; një program bashkëpunimi dypalësh ndërkufitar me Greqinë; programe transnacionale të BE-së në Europën Juglindore dhe në Mesdhe, si dhe në programin rajonal të Adriatikut. Gjithashtu, shoqëria civile ka marrë mbështetje financiare nga BE për projekte në fushat e drejtësisë (aksesi në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe monitorimi/përmirësimi i kushteve të jetesës në sistemin penitenciar), mbrojtjen e grupeve vulnerabil (gratë në pozita të pafavorshme, fëmijët dhe të moshuarit dhe grupet e minoriteteve) dhe mbrojtjen mjedisore.

10 KE, Raport Progresi i Shqipërisë 2012, Bruksel, 10 tetor 2012 (fq. 4).

1. KËRKESAT STRUKTURE

Institucionet e qeverisë qendrore

Sekretariati Teknik (ST) për Komunitetin Rom është krijuar pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSH) si pjesë e Departamentit për Monitorimin e Strategjive. Kjo zyrë përbëhet nga 3 vetë dhe një person shtesë pritet të emërohet së shpejti. ST është ngarkuar me monitorimin e zbatimit të SKPKJKR-së, koordinimin me të gjitha institucionet përkatëse të qeverisë qendrore dhe vendore, dhe koordinimin me OSHC-të lokale dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare. Një nga 3 persona të punësuar në ST është nga komuniteti rom. Ndërsa personeli i ST-së është tepër aktiv, vendndodhja e ST-së nënkupton se mund të monitorojë por nuk mund të ketë autoritet të mjaftueshëm për formimin e kuadrit të politikave, udhëzimeve dhe programeve, veçanërisht në lidhje me numrin e madh të institucioneve të qeverisë qendrore dhe vendore të përfshira në zgjidhjen e çështjeve të komunitetit rom.

Figura 1.

Si i vlerësoni përpjekjet e Qeverisë(ve) për zgjidhjen e problemeve kryesore të komunitetit rom?





Figura 2.

Nëse janë të pamjaftueshme, sipas mendimit tuaj cilat janë arsyt kryesore?



Grupi Ndërmintor i Punës (GP) për komunitetin rom është krijuar në vitin 2003, i kryesuar nga Zëvendësministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe i përbërë nga 10 anëtarë të tjerë që përfaqësojnë Ministrinë përkatëse në nivel zëvendësministrash. OJQ-të romë ftohen gjithashtu të marrin pjesë në GP. GP organizon dy mbledhje në vit që analizojnë raportet 6 mujore të përgatitura nga ST dhe diskutojnë çdo veprim të rëndësishëm në lidhje me komunitetin rom. Praktikisht, roli i GP është më shumë shkëmbimi i informacioneve

për të nxitur koordinimin midis të gjitha Ministrive përkatëse. Zëvendësministrat nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e GP. Kështu, në mbledhjen e fundit të 13 dhjetorit 2012 nuk ishte i pranishëm asnjë nga Zëvendësministrat. Përveç kësaj, janë caktuar 11 "Pika Kontakti" në 10 Ministri dhe në Njësinë Anti-Trafik.

Pavarësisht nga kompetencat përkatëse të personelit të ST, kësaj strukture i mungon autoriteti i nevojshëm për të koordinuar politikat në Ministri dhe për të ushtruar ndikim tek autoritetet që menaxhojnë fondet e BE-së. Propozimi për ta shndërruar ST në një Agjenci Kombëtare nën varësi të Kryeministrit është objekt diskutimi. Përveç kësaj, "Pikat e Kontaktit" në Ministri të ndryshme janë personel ekzistues i angazhuar në çështjet rome kryesisht pa e pasur këtë funksion specifik të përfshirë në përshkrimin e tyre të punës. Nuk ka patur alokim specifik buxhetor për ofrimin e shërbimeve të rëndësishme sociale për komunitetin rom dhe ka një varësi të madhe nga shoqëria civile dhe donatorët ndërkombëtarë në këtë fushë.

Autoritetet lokale

Në nivel vendor është krijuar një Komitet Koordinues për Programimin, Vlerësimin dhe Koordinimin e Mbrojtjes Sociale në çdo Këshill Qarku. Përveç kësaj, është krijuar një Grup Teknik për çështjet rome, i përbërë nga përfaqësues të të gjitha njësive administrative që kanë banorë romë, përfaqësues të Departamenteve Rajonale në varësi të Qeverisë Qendrore,¹¹ përfaqësues të OJQ-ve rome dhe OJQ-ve të tjera përkatëse lokale.

Në përgjithësi, të gjitha strukturat e mësipërme institucionale në nivel vendor janë më të përfshira në koordinimin e masave për zgjidhjen rast pas rasti të problemeve rome sesa në formulimin, vlerësimin dhe monitorimin e politikave. Në fakt, hartimi i politikave është një funksion ekskluziv i Ministrive dhe institucionet rajonale dhe institucionet e qeverisë vendore janë ngarkuar vetëm për të zbatuar politikat dhe strategjitë e miratuara nga qeveria qendrore. Si rezultat, zëri i tyre nuk dëgjohet në nivel politikash, me përjashtim të rasteve kur ftohen në seminarët e organizuara nga Ministrinë për shkëmbimin e opinionëve mbi strategjitë e hartuara.

Nuk ka politika vendore ose plane vendore veprimi në lidhje me komunitetin rom. Gjithashtu, mungojnë plotësisht të dhëna të ndara statistikore lokale mbi komunitetin rom. Për herë të parë, një sistem mbi grumbullimin e të dhënave është duke u zbatuar fillimisht në katër Rajone,¹² i mbështetur nga UNDP.

Koordinimi

GP Ndërmintor për Romët dhe Grupi Teknik për çështjet rome janë përgjegjës për koordinimin në nivele të ndryshme të qeverisjes. ST bën përpjekje bashkërenduese midis institucioneve të qeverisë qendrore dhe vendore. Megjithatë, autoriteti i tij për realizimin e këtij koordinimi është tepër i kufizuar.

Përveç kësaj, një numër i madh agjencish ndërkombëtare donatore po bëhen gjithnjë e më të interesuara për mbështetjen e çështjeve rome në Shqipëri nëpërmjet projekteve të zbatuara nga ata vetë ose nëpërmjet OJQ-ve ndërkombëtare dhe/ose lokale. Deri më sot, ST ka bërë disa përpjekje koordinuese nëpërmjet organizimit të takimeve vjetore informative të këtyre donatorëve/organizatave. Ekziston një nevojë për institucionalizimin e këtij koordinimi, me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe rritjen e efikasitetit të financimit.

Mospërputhjet

Është mjaft i vështirë dhe madje mund të konsiderohej i parakohshëm diskutimi dhe vlerësimi i mospërputhjeve midis politikave kryesore dhe synimeve në Shqipëri në lidhje me komunitetin rom. Në

11 Departamenti Rajonal Arsimor, Departamenti Rajonal i Punësimit, Departamenti Rajonal i Shërbimeve Sociale Shtetërore, Departamenti i Shëndetit Publik dhe Departamenti Rajonal i Policisë janë institucione rajonale në varësi të Ministrive të Qeverisë Qendrore.

12 Rajonet e Elbasanit, Fierit, Durrësit dhe Tiranës.

këtë fazë, pikënisje e vlerësimit mund të ishte numri shumë i madh i dokumenteve strategjike në lidhje me përfshirjen sociale, çështjet gjinore dhe të fëmijëve, si dhe trafikimin e qënjeve njerëzore, që përfshijnë objektiva dhe masa të lidhura me komunitetin rom, gratë rome dhe fëmijët romë. Ndërkohë, ekzistojnë dokumente strategjike dhe Plane Veprimi të lidhura specifkisht me komunitetin rom, të cilat janë ndryshuar kohët e fundit ose janë zëvendësuar pjesërisht nga dokumente të tjera të sugjeruara. Numri i madh i strukturave të ngjashme institucionale është gjithashtu "pasqyrim" i kësaj shumëllojshmërie dokumentesh strategjike. Shumë shpesh këto nisma ndikohen nga kriteret e harmonizimit të MSA-së.

Në këtë kontekst ekziston një nevojë për një qasje të njësuar para së gjithash brenda institucioneve përkatëse të BE-së, të përshtatura më së miri me "madhësinë", kontekstin dhe mundësitë shqiptare dhe më pas për një vendimmarrje më të vemendëshme ndaj efektivitetit dhe efikasitetit të vendimeve të tyre në lidhje me dokumentet strategjike dhe strukturat e ngjashme institucionale. Kjo lidhet, për shembull, me një numër shumë të madh dokumentesh strategjike dhe Planesh Veprimi të miratuara nga Ministri të ndryshme për sektorë të ndryshëm që lidhen me çështjen rome, shpesh "të imponuara" nga institucione të BE-së ose nga mbështetja me asistencë teknike e BE-së në kuadrin e procesit të stabilizim asociimit. Ka nevojë për qasje sinergjike në lidhje me masat prioritare dhe mbështetjen financiare. Nga pikëpamja institucionale, numri i madh i institucioneve, strukturave dhe pikave të kontaktit në lidhje me çështjet rome nuk ka rezultuar as efektiv, as eficient. Për shembull, është shumë i diskutueshëm efektiviteti i krijimit të dy institucioneve të veçanta si Avokati i Popullit dhe Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) me objekt të ngjashëm pune.

Politikat e monitorimit dhe vlerësimit

Nga pikëpamja formale funksionet e monitorimit dhe vlerësimit janë të mirë-përcaktuara në strukturat ekzistuese institucionale dhe ka shembuj të raporteve të progresit të realizuara prej tyre në lidhje me zbatimin e strategjive dhe Planeve të Veprimit, si dhe në lidhje me zbatimin e ligjeve të ndryshme. Megjithatë, shumë shpesh këto raporte janë plot me përshkrime për aktivitetet dhe u mungon analiza e rezultateve kundrejt objektivave fillestare. Raportet e Qeverisë mbi zbatimin e PVDR-së dhe të KMD mbi monitorimin e Ligjit Anti-Diskriminim janë shembuj tipikë raportesh tepër të përgjithshme.

Në këtë drejtim ekziston një nevojë për të paktën dy përmirësime themelore:

- Përfundimi i Strategjive dhe i Planit të Veprimit me objektiva të qarta dhe synime të matshme; dhe
- Krijimi i sistemit të mbledhjes të të dhënave, i harmonizuar me synimet e mësipërme, si dhe përgatitja e një modeli raportimi të standardizuar në të gjitha nivelet e raportimit.

Burimet buxhetore

Ekziston një shqetësim i përgjithshëm në Shqipëri në lidhje me dokumentet strategjike dhe Planet përkatëse të Veprimit: "tradicionalisht" nuk ka kosto të llogaritur të masave prioritare dhe informacion mbi buxhetin e alokuar për zbatimin e tyre. Si rezultat, mundësia reale që strategjitë dhe Planet e Veprimit të zbatohen është shumë e ulët dhe ato mbështeten gjerësisht në financimin e huaj, duke përfshirë projektet e OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare. Ekziston një nevojë për ndryshim themelor në këtë qasje.

Mbështetja financiare e be-së

Shqipëria është inkurajuar nga BE¹³ që të shfrytëzojë plotësisht instrumentet financiare si IPA në përpjekjet e saj për arritjen e përfshirjes sociale të grupeve vulnerabël. Si rezultat, rreth 26 milionë EURO u planifikuan

13 Delegacioni i KE-së në Tiranë, Seminar mbi Përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në kuadrin e Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, Tiranë, 15 dhjetor 2011.

të mbështesnin sektorin e zhvillimit social gjatë periudhës 2011-2013,¹⁴ duke përfaqësuar rreth 10% të buxhetit total të alokuar për Shqipërinë nga programi IPA. Pjesë e këtij buxheti është parashikuar të mbështesë masat që parandalojnë përjashtimin social dhe të përgatisë politikat/masat e përfshirjes sociale për grupet më vulnerabel, kryesisht popullsinë rome dhe minoritete të tjera si egjiptianët ballkanas, si dhe për të nxitur barazinë midis burrave dhe grave dhe për të forcuar luftën kundër diskriminimit.

IPA 2011 ofroi 1.5 milionë EURO për mbështetjen e integritit të komunitetit rom, duke përfshirë edhe një komponent për forcimin e kapaciteteve të ST-së. Më tej, IPA 2012 parashikohet të ofrojë mbështetje financiare për mbrojtjen e grupeve vulnerabel, veçanërisht të minoriteteve si romët dhe egjiptianët, nëpërmjet ndërhyrjeve të posaçme për rritjen e nivelit të përfshirjes dhe projekteve të financuara nga thirrja për propozime prej OSHC-ve.

Në përgjithësi, përfaqësues të komunitetit rom (OJQ rome dhe lidera komuniteti) nuk janë ftuar të marrin pjesë në mënyrë aktive në programimin e këtyre burimeve financiare. Opinioni i tyre i përgjithshëm është se pjesa kryesore e financimit adreson mbështetje institucionale dhe jo nevojat e tyre reale në lidhje me zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Përveç kësaj, një përgjegjësi e orientuar ndaj rezultatit duhet të zhvillohet nga BE si donator në lidhje me financimin nga BE. Për shembull, Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 u financua dhe u mbështet me asistencë teknike nga BE¹⁵ dhe rezultatet e kundërshtuara në lidhje me komunitetin rom u publikuan nga INSTAT duke përdorur edhe logon e BE-së.

14 IPA, Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar 2011-2013, Shqipëri.

15 Kostoja e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 u mbulua nga Bashkimi Europian (rreth 9 milionë Euro) dhe pjesërisht nga Konfederata Zvicerane.

2. ANTI-DISKRIMINIMI

Regjistrimi dhe kartat e identitetit

Nga burime referuese, popullsia rome në Shqipëri është llogaritur 1,300-120,000 banorë. Mospërputhja e dukshme midis këtyre dy shifrave ndodh prej faktit se deri në vitin 2011 asnjë regjistrim zyrtar i popullsisë në Shqipëri nuk ka përmendur komunitetin rom. Kështu, gjatë regjistrimit të popullsisë të vitit 1989, komuniteti rom përfshihej në kategorinë “të tjerë”, së bashku me vllahët dhe minoritete të tjera të vogla. Natyrisht, një pjesë e madhe e komunitetit rom mbeti “e fshehur” në shifrën e grupeve të tjera etnike të regjistruara: shqiptarë, grekë, maqedonas, serbë dhe malazezë. Nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2001 nuk u ofrua asnjë e dhënë mbi grupet etnike.

Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Minoriteteve ka llogaritur një numër prej 90,000-100,000 banorë romë.¹⁶ Kërkues si Poulton,¹⁷ Brunner¹⁸ dhe Bugajski¹⁹ pretendonin për një numër të komunitetit rom përkatësisht prej 10,000, 60,000 dhe 100,000. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) konsiderojnë se janë rreth 100,000²⁰ romë. Duke iu referuar llogaritjeve më të përditësuara të KE-së të muajit korrik 2012, popullsia rome në Shqipëri përfaqëson mesatarisht rreth 3.5% të popullsisë totale të Shqipërisë. Burime nga OJQ-të shqiptare për komunitetin rom konsiderojnë se janë 80,000-120,000 romë. SKPKJKR shqiptare i është referuar në mënyrë të tërthortë një numri prej më shumë se 25,000 romë. Së fundi, Banka Botërore²¹ (BB) ka çmuar se popullsia rome në Shqipëri mund të llogaritet midis 1,261 dhe 90,000-100,000 personave, që përfaqësojnë përkatësisht nga rreth 0.04% në 3% të popullsisë shqiptare gjithsej.

Një Raport tjetër²² shpjegon se romët shqiptarë u regjistruan fillimisht gjatë një “regjistrimi popullsie” të vitit 1522, kur u llogaritën rreth 1,270 romë që banonin në 374 kampe të njohura (me zjarre në ambiente të hapura).²³ Në vitin 1930, sipas një vlerësimi popullor, në të gjithë vendin ndodheshin 20,000 romë. Në vitin 1980 u raportua se në Shqipëri kishte 62,000 romë. I njëjti raport vlerësoi, gjithashtu, se niveli i rritjes të popullsisë rome ishte më i lartë sesa ai i popullsisë shqiptare. Një studim i fundit i shpërndarjes gjeografike të romëve është kryer gjatë periudhës prill-nëntor 2011²⁴ dhe është fokusuar në 108 komunitete rome. Sipas këtij studimi, numri i përgjithshëm i fëmijëve romë në Shqipëri është 6,304, që përfaqësojnë rreth 43.3% të popullsisë së përgjithshme rome. Kjo i korrespondon një numri total prej rreth 15,000 romë.

Cështja e regjistrimit të popullsisë rome ishte parashikuar të zgjidhej përfundimisht nëpërmjet Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 (Census 2011) por rezultatet përfundimtare të shpallura kohët e fundit nga INSTAT më 13 dhjetor 2012 treguan se komuniteti rom në Shqipëri përfaqëson vetëm 0.3% të popullsisë totale që jeton në Shqipëri²⁵ (që i korrespondon më pak se 8,500 personave). Kjo është një shifër mjaft e ndryshme nga të gjitha llogaritjet e mësipërme. Si rezultat, Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 nuk arriti të paraqiste të dhëna statistikore të besueshme për komunitetin rom. Në fakt, një raport monitorues i Regjistrimit të Popullsisë i vitit

16 Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Minoriteteve, 1995.

17 Poulton, H, Ballkani: Minoritetet dhe Shtetet në Konflikt, London, 1991.

18 Bruner, G. Nemzetisegi kerdes es kisebbsegi konfliktusor Kelet-Europaban, Budapest, 1995.

19 Bugajski, J. Politika Etnike në Europën Lindore, NY, 1994.

20 Departamenti Amerikan i Shtetit, Raport Vendi për Shqipërinë mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut, janar 1997.

21 Banka Botërore, Përmbledhje mbi Komunitetin Rom, prill 2010.

22 Qendra për Dokumentacionin dhe Informacionin mbi Minoritetet në Europë- Europa Juglindore, Romët e Shqipërisë, gusht 2000.

23 Kjo shifër mund të konsiderohet nga Banka Botërore si shifër zyrtare (!).

24 Një studim i shpërndarjes gjeografike u krye nga CESS me financimin e UNICEF-it. Shihni: Shpërndarja Gjeografike e Fëmijëve Romë në Shqipëri, UNICEF – nëntor 2011.

25 Fjalimi i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it për rezultatet përfundimtare të Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011, Tiranë, 13 dhjetor 2012.

2011 shfaqti më parë probleme në lidhje me zbatimin e procesit të regjistrimit të popullsisë rome.²⁶ Një javë para përfundimit të regjistrimit, një në tre familje rome e pyetur nga anketuesit deklaroi se nuk ishte kontaktuar nga regjistruesit; rreth 67% e tyre i konsideruan pyetjet e përfshira në pyetësor si të vështira për t'iu përgjigjur, rreth 40% e tyre mendonin se regjistruesit nuk ishin të qartë, të duruar dhe të qetë; dhe në më shumë se 50% të familjeve të anketuara regjistruesit ishin jo romë ose të pa shoqëruar nga përfaqësues romë.²⁷

Për sa i përket regjistrimit të komunitetit rom nga Zyrat Vendore të Gjendjes Civile, është bërë progres gjatë ofrimit të kartave të reja të identitetit për popullsinë. Kjo lidhet me masat e mëposhtme të marra nga institucionet shqiptare:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mori në konsideratë sugjerimet e OJQ-ve vendore, të cilat propozuan në vitin 2008 ndryshimin e Ligjit ekzistues "Mbi Gjendjen Civile",²⁸ me qëllim lehtësimin e regjistrimit. Pas miratimit nga Parlamenti, janë regjistruar rreth 7,000 fëmijë, shumica prej të cilëve fëmijë romë;
- Një Direktivë e Ministrisë së Brendshme (MB) e vitit 2009 lehtësoi më tej (liberalizoi) procedurat e regjistrimit të lindjeve për fëmijët romë, duke marrë parasysh vulnerabilitetin e tyre të veçantë ndaj trafikimit për shkak të mungesës të regjistrimit të lindjeve;
- Në bazë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave (VKM) të dhjetorit 2008, për rreth 5,000 romë u shpërndanë karta identiteti falas.

Regjistrimi i romëve është konsideruar çështje e rëndësishme edhe nga PVDR si pjesë e sektorit të përfshirjes sociale dhe Shanseve të Barabarta, duke përfshirë dy detyra kryesore:


- Ofrimin falas të kartave të identitetit për komunitetin rom; dhe
- regjistrimin e romëve në gjendjen civile.

Numri total i popullsisë rome, numri i romëve të pajisur me karta identiteti dhe përqindja e romëve të paregjistruar në regjistrin vendor civil janë identifikuar si tregues kryesorë²⁹ të lidhur me procesin. Megjithatë, për këtë qëllim nuk janë përcaktuar objektiva dhe për rrjedhojë, të dhënat përkatëse statistikore nuk janë të disponueshme në institucionet shqiptare përgjegjëse.

Regjistrimi i romëve i është nënshtruar analizave dhe rekomandimeve nga disa Raporte Progresi të KE-së. Në vitin 2009 u theksua nevoja për më shumë vëmendje ndaj regjistrimit të pakryer të minoritetit rom; në vitin 2010 u përmend mungesa e të dhënave të sakta për minoritetet në Shqipëri dhe pritshmëria për të trajtuar këtë çështje nga Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011; në vitin 2011 u përmend se megjithëse janë zhvilluar fushata regjistrimi dhe aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit, disa romë nuk janë regjistruar ende zyrtarisht; dhe në vitin 2012 u vlerësuan pozitivisht vendimet administrative për të lehtësuar procedurat e regjistrimit të lindjeve dhe përfshirja e pyetjeve optimale mbi origjinën etnike në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011.

Pengesat për regjistrimin e romëve në Zyrat vendore të Gjendjes Civile janë tepër komplekse. Pengesat teknike (psh, mospasja e dokumenteve të nevojshme), mungesa e njohurive mbi sistemin, emigrimi, lëvizshmëria e familjeve rome mund të konsiderohen si disa pengesave kryesore.

Figura 3. A jeni informuar mbi ekzistencën e Ligjit për mbrojtjen nga anti-diskriminimi?



26 HDPC, Regjistrimi i familjeve rome – mbështetje për Regjistrimin e Popullsisë, 2011, Raport Përfundimtar, Tiranë, dhjetor 2011.

27 Sondazhi përfshinte 870 familje rome në 13 rrethe.

28 Ligji Nr 895, datë. 10.10.2002.

29 MPÇSSH dhe UN Albania, Udhëzime mbi Monitorimin e Progresit dhe Raportimi i Treguesve të Planit Kombëtar të Veprimit për Dekadën e Përfshirjes Rome 2010-2015, Tiranë, 2011.

Racizmi dhe diskriminimi ndaj komunitetit rom

Kuadri ligjor dhe institucional kundër diskriminimit është përmirësuar dukshëm në Shqipëri. Ndërsa pothuajse të gjitha konceptet kryesore kundër diskriminimit të zhvilluara nga Direktiva e BE-së për Barazi Raciale³⁰ janë konsideruar në KSH dhe në disa Ligje përkatëse, deri në vitin 2009 ka patur pak progres mbi hartimin e përkufizimit të të duhur ligjor të diskriminimit apo të legjislacionit specifik kundër diskriminimit, megjithëse disa dispozita kundër diskriminimit ishin përfshirë më parë në pjesë të veçanta të legjislacionit.

Në vitin 2009, në konsultim me OSHC-të u hartua Ligji mbi Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe më pas, në shkurt të vitit 2010, Ligji u miratua nga Parlamenti.³¹ Objekti i këtij akti është garantimi i të drejtës së çdo personi për:

- barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë me ligj;
- mundësi dhe shanse të barabarta për ushtrimin e të drejtave, gëzimi i lirive dhe pjesëmarrja në jetën publike; dhe
- mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë e sjelljes që nxit diskriminimin.

Figura 4.
A mendoni se komuniteti rom është i diskriminuar në Shqipëri?




Figura 5.
Nëse po, cilët janë më të diskriminuar?





Figura 6.
Nëse po, nga kush janë më të diskriminuar?



30 Direktiva e Këshillit 2000/43/KE.

31 Ligji Nr. 10221, datë 4.02.2010.

Ligji deklaron qartë ndalimin e diskriminimit, mbrojtjen nga diskriminimi, ushtrimin e të drejtës për të votuar, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një funksion publik, lirinë e ndërgjegjes dhe fesë, mbrojtjen nga diskriminimi në punësim dhe arsim, si dhe mbrojtjen në fushën e mallrave dhe shërbimeve.

Ligji Kundër Diskriminimit i referohet dhe është në përputhje të plotë me katër Direktivat kryesore Europiane përkatëse:

- Direktiva e Këshillit 2000/43/KE e 29 qershorit 2000 "Mbi parimin e trajtimit të barabartë midis personave, pavarësisht nga origjina raciale ose etnike";
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE e 27 nëntorit 2000 "Krijimi i një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion";
- Direktiva e Këshillit 2004/113/KE e 13 dhjetorit 2004 "Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në aksesin dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve"; dhe
- Direktiva e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 2006/54/KE e 5 korrikut 2006 "Mbi zbatimin e parimit të mundësive dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit".

Rezultati i menjëhershëm pozitiv i zbatimit të këtij Ligji ishte krijimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Sipas Ligjit, KMD u caktua nga Parlamenti,³² i cili miratoi edhe organigramën e Zyrës së Komisionerit.³³ KMD nuk është pjesë e një partie politike dhe stafi i emëruar nuk mban pozicione të tjera në institucionet qeveritare. Funksionet kryesore të KMD-së fokusohen në rishikimin dhe shqyrtimin e ankesave të subjekteve që pretendojnë të jenë viktimat e sjelljes diskriminuese; monitorimin e perceptimeve mbi diskriminimin dhe përgatitjen e raporteve monitoruese mbi anti-diskriminimin, si dhe dhënien e rekomandimeve. Pas shqyrtimit të ankesave, KMD mund të vendosë edhe gjoba nga 10,000 në 80,000 LEK.³⁴ Një Plan Veprimi për udhëzimin dhe zbatimin e këtij Ligji nuk është përgatitur ende dhe nuk ka të dhëna mbi alokimet e buxhetit për mbështetjen e zbatimit të tij.

Sipas Ligjit kundër Diskriminimit, çdo person ose grup personash që pretendojnë se është ushtruar diskriminim kundër tyre, mund të ngrenë padi në gjykatën kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërbim sipas ligjit, ose, nëse është rasti, mund të depozitojnë kallëzim penal pranë organeve kompetente për ndjekje penale. Depozitimi i një ankese para Komisionerit nuk është kusht për ngritjen e një padie dhe nuk përbën pengesë për palën e dëmtuar që t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale. Një organizatë me interes të ligjshëm ose vetë Komisioneri mund të ngrenë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që Komisioneri ose organizata të kenë miratim me prokurë të posaçme si përfaqësues të personit ose grupit të personave të prekur nga diskriminimi.

Ka pak të dhëna mbi përfitimet e komunitetit rom nga zbatimi i Ligjit kundër Diskriminimit. Masat për ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për të krijuar një perceptim mbi integritimin e komunitetit rom janë më të lidhura me ngjarje specifike sesa sistemike, gjeografikisht të fokusuar në disa rajone sesa në të gjithë vendin, dhe të financuara vetëm nga Agjenci donatore ndërkombëtare në kuadrin e projekteve të

NCIDENTE QË PËRFSHIJNË FAMILJET ROME

"Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Ambasada Amerikane në Shqipëri dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri janë informuar se gjatë javës së 20 shkurtit 2011 dhjetra familje rome u dëbuan me forcë nga vendbanimet e tyre në qendër të Tiranës nga persona të paidentifikuar që u vunë zjarrin strehave të tyre dhe i dëbuan nga shtëpitë. Ne vërejmë se këto veprime çuan në disa plagosje të rënda dhe zhvendosje të një numri të madh personash, duke përfshirë shumë fëmijë. Ne vërejmë se Shqipëria është angazhuar zyrtarisht ndaj objektivave të Deklaratës së Dekadës të Përfshirjes Rome dhe ka ratifikuar Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve, si dhe Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. Komisioni Europian, sipas Opinionit të tij për kërkesën për anëtarësim të Shqipërisë, ka identifikuar luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të komunitetit rom si fusha prioritare kyçe, që kërkojnë vëmendje të veçantë nga autoritetet. Në këtë kuadër, i kërkojmë fuqimisht autoriteteve përgjegjëse që të marrin masat e duhura nëpërmjet hetimit të ngjarjeve shqetësuese të shkurtit, me qëllim garantimin e mospërsëritjes të këtyre akteve. Ne, gjithashtu, inkurajojmë autoritetet që të marrin masat e duhura për ofrimin e ndihmës sociale të nevojshme, përfshirë strehimin, për ata persona që tashmë gjenden të pastrehë. OSBE, SHBA dhe BE i bashkohen plotësisht përfaqësuesve të shoqërisë civile, duke kërkuar dhënien fund të diskriminimit dhe dhunës për familjet dhe fëmijët romë".

Tiranë, 16 mars 2011

32 Ligji Nr. 33, datë 22.04.2010.

33 Ligji Nr. 34, datë 20.05.2010.

34 Shumat janë të barazvlefshme me 100 dhe 800 USD.

tyre dhe/ose projekteve lokale të OJQ -ve. Kjo vlen edhe për përpjekjet e bëra për nxitjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e qytetarëve romë. Kjo tregohet qartë nga informimi i pakët i publikut të gjerë dhe qytetarëve romë mbi ekzistencën dhe dispozitat e Ligjit mbi Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përfitimet e tyre nga ky Ligj.³⁵

Avokati i Popullit i sapoemëruar ka marrë përsipër një rol proaktiv në incidentet që përfshijnë 45 familje rome në Tiranë.³⁶ Tetë familje rome u strehuan për një javë në ambientet e Zyrës së Avokatit të Popullit ndërsa të tjerë u strehuan nga MPÇSSHB në një kamp emergjence të mbështetur edhe nga katër OJQ. Avokati i Popullit informoi të gjitha institucionet përkatëse të qeverisë qendrore dhe Parlamentin, si dhe realizoi një fushatë për informimin publik mbi çështjen, duke dhënë rekomandime mbi mënyrën e zgjidhjes së këtij problemi. Ndërkohë, familjet rome përfituan asistencë sociale dhe ndihmë humanitare.

Megjithatë, deri tani nuk ka të dhëna për një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje, përfshirë strehimin, masat e duhura mbi hetimin e incidenteve dhe identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës.

Diskriminimi institucional

Autoritetet publike dhe ofruesit e shërbimeve publike në Shqipëri nuk e pranojnë ekzistencën e diskriminimit institucional të komunitetit rom, në bazë të dy argumenteve kryesore:

- është miratuar kuadri ligjor kundër diskriminimit në përputhje me standardet përkatëse të BE-së dhe i vlerësuar e vëzhguar me kujdes nga partnerë ndërkombëtarë; dhe
- në të gjitha strategjitë e qeverisë dhe programet qeveritare mund të identifikohet lehtësisht vëmendja e veçantë dhe mbështetja specifike për minoritetet etnike.

Libra falas për fëmijët romë, programi i edukimit për një mundësi të dytë, përfshirja e romëve në programe për nxitjen e punësimit, fushata për vaksinimin falas të komunitetit rom, përfshirja e komunitetit rom në programet e Bashkive për strehimin social, janë disa shembuj për këtë argument.

Megjithatë, pavarësisht nga 20 vjet demokraci, institucionet qeveritare nuk kanë arritur të japin ende të dhëna të sakta statistikore për komunitetin rom dhe kjo përfaqëson një shembull të rëndësishëm të diskriminimit institucional për komunitetin rom. Përveç kësaj, mungon mbledhja efektive e të dhënave, raportimi dhe menaxhimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Komunitetin Rom, nuk ka të dhëna për alokimin e burimeve financiare në nivel kombëtar dhe vendor për çështje kundër diskriminimit, institucionet e qeverisë qendrore dhe vendore nuk janë proaktive për parandalimin e diskriminimit dhe hetimin e incidenteve përkatëse.

Mund të përmendim tre shembuj të tjerë tipikë të diskriminimit institucional: (i) Incidentet e shkurtit 2011 në Tiranë nuk janë zgjidhur ende;³⁷ (ii) Dhuna e policisë bashkiake të Tiranës në korrik 2012 kundër Romëve, që mbledhin kuti konservash dhe shishe plastike në kazanët e hedhurinave të Tiranës; (iii) çështja e vajzës së re rome, e cila pas përfundimit të studimeve universitare në dy fakultete, aplikoi për punë dhe nuk u punësua për shkak të paragjyqimeve mbi origjinën e saj etnike.³⁸

DHUNA KUNDËR ROMËVE QË MBLEDHIN KUTI KONSERVASH DHE SHISHE PLASTIKE

Policia bashkiake e Tiranës ushtroi dhunë dhe u mori romëve mjetet e transportit, duke e konsideruar mbledhjen e kutiave të konservave si aktivitet të paligjshëm dhe duke mos marrë në konsideratë se kjo është e vetmja mundësi "punësimi" për komunitetin rom në Tiranë. Rreth 700 familje rome u prekën nga kjo ngjarje. Pavarësisht protestave të komunitetit rom dhe angazhimit të Avokatit të Popullit në një hetim të pavarur, mungon një zgjidhje ligjore për çështjen. Shefi i policisë bashkiake madje refuzoi t'i jepte shpjegime Avokatit të Popullit, duke e shpërfilluar kërkesën. Sipas disa raporteve mediatike, mbrapa kësaj çështjeje kishte një biznes privat, që është favorizuar nga policia bashkiake.

35 Në bazë të rezultateve paraprake të studimit tonë.

36 Ky incident ndodhi në shkurt 2011. 45 familje rome u dëbuan me forcë nga qytetarë nga vendbanimi i tyre afër stacionit të trenit të Tiranës. Familjeve të cenuara iu dha alternativë por akomodim disi i pamjaftueshëm nga autoritetet në formën e tendave në një zonë të largët të qytetit. Ata u ndihmuan nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht në lidhje me ndjekjen gjyqësore të çështjes.

37 Sipas perceptimit të organizatave rome, në këtë çështje ka një shkallë presioni politik.

38 Çështja u publikua në media më 20 dhjetor 2012. Kërkesa e fundit e E.Y. është paraqitur në Bashkinë e Pogradecit, ajo u shpall fituese dhe më pas kontrata u refuzua duke u zëvendësuar nga një kandidate pa aftësitë e duhura, e cila i përkiste shoqërisë mazhoritare.

Institucioni i anti-diskriminimit

I krijuar në shkurt 2010, institucioni i KMD-së fokusohet në tre funksione kryesore:

- Mbështetje për viktimat e diskriminimit nëpërmjet rishikimit të ankesave; kryerja e hetimeve administrative; vendosja e sanksioneve administrative; dhe përfaqësimi i ankuesve në gjykatë për çështje civile;
- Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; dhe
- Përgatitja e raporteve për çështje kundër diskriminimit, propozimi i përmirësimit të kuadrit ligjor dhe realizimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik.

ANKESA E ORGANIZATËS ROME PËR INCIDENTIN E MUAJIT SHKURT 2011

Përfaqësuesi i Unionit Rom "Amaro Drom" i paraqiti më 28 mars 2011 një ankesë Komisionerit në lidhje me incidentin e muajit shkurt 2011, duke pretenduar diskriminim etnik nga një grup të rinjsh shqiptarë, nga të cilët dy janë arrestuar nga policia. Pas verifikimit të dokumenteve, Komisioneri e konsideroi të pavlefshme ankesën pasi përfaqësuesi i organizatës nuk ishte i pajisur me prokurë të posaçme të kërkuar me Ligj. Ndërkohë, organizata tërhoqi ankesën.


2011 Raporti Vjetor i Komisionerit, shkurt 2012

Institucioni i Komisionerit ka tashmë organigramën e vet të përbërë nga tri drejtori: Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Procedurale dhe Marrëdhënive me Jashtë; Drejtoria e Inspeksionit dhe Hetimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Pjesë e kësaj strukture është edhe Sektori i Marrëdhënive me Publikun.

Në lidhje me funksionin e parë, numri total i ankesave gjatë vitit 2011 ishte 15, nga të cilat vetëm tetë u konsideruan në përputhje me Ligjin. KMD kundërshtoi katër ankesa, paraqiti rekomandime për një ankesë dhe tre ankesa të tjera janë duke u shqyrtuar. U depozitua vetëm një ankesë në lidhje me diskriminimin e komunitetit rom (mbi incidentin e muajit shkurt 2011) që u kundërshtua nga KMD për arsye procedurale, që mund të jenë pengesa për komunitetin rom edhe në raste të ardhshme. Megjithatë ky ishte viti i parë i veprimtarisë për këtë institucion, KMD duket të mos nxisë mjaftueshëm ankesat dhe të mos i shqyrtojë hollësisht çështjet e paraqitura. Përveç kësaj, komuniteti rom nuk ka njohuri të mjaftueshme mbi Ligjin e ri për sa i përket të drejtave të tyre dhe procedurave që duhet të ndiqen prej tyre.

Figura 7.

Cilat janë institucionet që ndihmojnë më shumë për zgjidhjen e problemeve të komunitetit rom?



Në lidhje me funksionin e dytë, KMD ka përshkruar statusin e diskriminimit në Shqipëri,³⁹ duke marrë në konsideratë veçanërisht punësimin, arsimin dhe shëndetësinë. Rezultatet bazohen në disa dokumente të përgatitura nga OSHC ndërkombëtare dhe lokale ose institucione ndërkombëtare, si dhe në një studim të realizuar nga KMD me fëmijë dhe mësues në pesë shkolla të mesme dhe nëntëvjeçare në pesë rrethe, duke testuar informimin e tyre mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Raporti është i pamjaftueshëm dhe tepër i përgjithshëm dhe nevojitet harmonizimi i tij me modelet e ngjashme të BE-së. Përveç kësaj, mungon vlerësimi i statusit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në lidhje me funksionin e tretë, KMD ka qenë aktive dhe ka paraqitur raporte në disa mbledhje kombëtare dhe ndërkombëtare,⁴⁰ ka dhënë opinione dhe komente mbi disa projektligje dhe ka marrë pjesë në

39 Raport i Komisionerit për Parlamentin Shqiptar, 22 shkurt 2012.

40 Shembull: Raport në Mbledhjen e Tretë BE – Shqipëri në kuadrin e MSA-së; raport në Sesionin e 79-të të Komitetit kundër Diskriminimit në Gjenevë.

veprimtari ndërgjegjësuere të organizuara në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare.⁴¹ Këto veprimtari mund të konsiderohen efektive, duke marrë parasysh se buxheti vjetor i Komisionerit kufizohet në rreth 260,000 EURO, nga të cilat rreth 70% janë alokuar për shpërblimin e personelit dhe vetëm rreth 15% janë alokuar për shërbimet që kryen ky institucion.

Pavarësisht nga masat e mësipërme, rezultatet e studimit tonë treguan se asnjë nga të anketuarit romë nuk ishte në dijeni të ekzistencës së KMD-së dhe KMD nuk shfaqej si një institucion që ndihmon për zgjidhjen e problemeve të komunitetit rom.

Direktivat e be-së mbi çështjet raciale dhe ankesat

Në legjislacionin shqiptar nuk ka boshllëqe të dukshme në krahasim me Direktivën e BE-së mbi Çështjet Raciale.⁴² E drejta për barazi përpara ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi për çdokënd përbën një të drejtë universale të njohur nga KSH dhe nga Ligji kundër Diskriminimit. Një krahasim i përgjithshëm midis këtij Ligji dhe Direktivës së BE-së mbi Çështjet Raciale⁴³ paraqitet në Tabelën 1. Përveç kësaj, institucioni i KMD-së është krijuar në përputhje me direktivën për forcimin e mbrojtjes kundër diskriminimit, bazuar në origjinën raciale ose etnike, si një organ kompetent për të analizuar problemet përkatëse, për të studiuar zgjidhje të mundshme dhe për të ofruar asistencë konkrete ndaj viktimave. Strategjitë ekzistuese kombëtare sektoriale dhe ndër-sektoriale, të përgatitura nga institucionet shtetërore analizojnë edhe komponentët e përfshirjes sociale. Kjo lidhet veçanërisht me dokumentet strategjike mbi punësimin, arsimin, shëndetësinë, shërbimet sociale, përfshirjen e komunitetit rom, anti-trafikimin etj.

Neni 34 dhe 35 i Ligjit ekzistues Kundër Diskriminimit konfirmon të drejtën e individëve ose grupeve të personave që pretendojnë se janë diskriminuar, por edhe të drejtën e OSHC dhe KMD, për t'u ankuar në gjykatën kompetente ose për të depozituar ankesa për ndjekje penale. Individë dhe grupe personash mund t'i drejtohen gjykatës mbi rastin e tyre të diskriminimit pa informuar paraprakisht KMD-në.⁴⁴ Deri tani, nuk janë raportuar raste diskriminimi të paraqitura për gjykim në gjykatat lokale ose në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut.⁴⁵ Numri shumë i ulët i ankesave konfirmon ndërgjegjësimin e pamjaftueshëm të komunitetit rom mbi të drejtën e romëve për ankim si dhe nevojën që ata kanë për ndihmë ligjore për rastet e diskriminimit.

PËRFSHIRJA NË POLITIKË

Përfshirja e romëve në politikë është jashtë çdo diskutimi. Krijimi i një rrjeti të grave në politikë u mbështet në Korçë nga OSBE. U përpoqa të kandidoj si anëtare e pavarur për këshillin bashkiak për të përfaqësuar komunitetet rome dhe egjiptiane. Sipas ligjit, një kandidat i pavarur mund të regjistrohet në zgjedhje në rast se mund të mbledhë 700 firma (kundrejt 300 firmave për të qenë kandidat i një partie politike). Unë mbledha 700 firma së bashku me fotokopjet e kartave të identitetit për secilin. Komisioni Zgjedhor kërkoi që 700 personat të paraqiteshin për konfirmim në zyrat e Komisionit, duke dhënë një afat prej 4 ditësh (nga të cilat një ditë ishte festë zyrtare). Duhet të dërgoja 4 autobusë në ditë në këto zyra. Ditën e parë mora 70 njerëz. Ata thanë: në rregull, mund të vazhdoni. Ditën e dytë dërgova 90 të tjerë. Por nuk ndodhej askush në zyrat e Komisionit dhe askush nuk u paraqit gjithë ditën. Dita e tretë ishte pushim. Ditën e katërt hoqa dorë pasi nuk kishte kuptim. Kështu dështova dhe nuk u regjistrova. Pas njëfarë kohe, kryetari i komisionit zgjedhor pranoi në mirëbesim se kjo ishte bërë qëllimisht pasi ata ishin të bindur se unë do të fitoja zgjedhjet.

E.T. Korçë, shkurt 2013

41 Shembull: Fushata kundër diskriminimit të organizuar nga OSBE në 6 shkolla të Tiranës; bashkëpunim me Qendrat Informative të BE-së në Tiranë dhe Vlorë për sesione informative.

42 Direktiva e Këshillit 2000/43/KE e muajit qershor 2000.

43 Direktiva e Këshillit 2000/43/KE e qershorit 2000.

44 Ndarja nuk përmendet shprehimisht si formë e veçantë diskriminimi, as në Direktivën e Çështjeve Raciale, as në Ligjin shqiptar.

45 Raport i Komisionerit për Parlamentin Shqiptar, 22 shkurt 2012.

Tabela 1:
Krahاسimi i Përgjithshëm midis Direktivës së BE-së mbi Çështjet Raciale dhe Ligjit Shqiptar Kundër Diskriminimit

Direktiva mbi Çështjet Raciale		Ligji Shqiptar	
Neni	Koncepte kyçe	Koment	Neni
2	Diskriminim direkt/indirekt, ngacmim, viktimizim	Janë shqyrtuar të gjitha	3
3	Kushtet për akses në punësim, vetëpunësim dhe profesion, përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit	Janë shqyrtuar të gjitha. Përveç kësaj: detyrimi i punëdhënësit, detyrat e KM-së, MPÇSSHB dhe MB, e drejta e punëmarrësit.	12,13,14,15
	Akses në të gjitha tipet dhe të gjitha nivelet e arsimit	Janë shqyrtuar. Përveç kësaj: detyrat e MASH, drejtues i një institucioni arsimor.	17
	Kushtet e punës dhe punësimit	Janë shqyrtuar	12
	Anëtarësimi në një organizatë	Janë shqyrtuar. Përveç kësaj: pjesëmarrja në politikë	12, 9
	Mbrojtja sociale, përfshirë sigurimet shoqërore dhe kujdesin shëndetësor	Nuk janë shqyrtuar qartë	
	Akesi dhe furnizimi i mallrave dhe shërbimeve	Janë shqyrtuar	20
8	Rregulli i barrës së provës	Janë shqyrtuar	36
11	Promovimi i dialogut social	Nuk janë shqyrtuar qartë	
12	Nxitja e dialogut me OJQ-të	Nuk janë shqyrtuar qartë	
13	Caktimi i një organi kundër diskriminimit	Janë shqyrtuar	21-32
15	Caktimi dhe zbatimi i rregullave mbi sanksionet	Janë shqyrtuar	33, 34, 38

Fëmijët romë

EDHE NE ËNDËRROJMË

Jam i papunë që prej 8 vjetësh. Paguhem 4,500 lek në muaj. Gjatë këtyre 8 viteve nuk më është ofruar punë. Jemi gjashtë persona që banojmë në një shtëpi. Gruaja ime dhe unë jemi me aftësi të kufizuara, kështu që nuk kemi asnjë mundësi punësimi. Kemi 4 fëmijë dhe askush nuk ka arritur moshën për të punuar. Si mund të jetojmë, hamë dhe kujdesemi për shëndetin e tyre? Ne jetojmë në një barrakë plasmasi që nuk është legalizuar, nga e cila mund të hidhemi lehtësisht në rrugë nga kushdo, në çdo kohë. Natyrisht që ne ëndërrojmë. Për çfarë ëndërrojmë? Për të patur një vakt ushqimi në ditë për fëmijët tanë dhe për të jetuar në një shtëpi të thjeshtë me dërrasa të legalizuar. Ky është Ronaldo, qeni im besnik. Mos ki frikë se nuk kafshon. Është mësuar me njerëzit dhe luan gjithë ditën me fëmijët e mi. Del nëpër qytet dhe gjen gjëra për të ngrënë tek plehurat. Kjo është shtëpia e tij, i kemi bërë një kolibe druri, madje i kam vënë një batanije që të mos ketë ftohtë. Përse e kemi vendosur këtë antenë televizori në kolibe? Fëmijët e kanë vënë; ata madje kanë vendosur një kuti këpucësh kartoni që me sa duket ngjan me një televizor. Ëndërroj që fëmijët e mi të jenë si Ronaldo. Jo si futbollisti, natyrisht, por si qeni im. Nuk jemi në gjendje t'i realizojmë këto ëndrra. Askush nuk na ndihmon.

Arben, Gjirokastër, shkurt 2013

Disa dokumente strategjike të miratuara nga QSH adresojnë të drejtat e fëmijëve dhe disa prej tyre përfshijnë masa specifike në lidhje me të drejtat e fëmijëve romë. Strategjia Kombëtare dhe Plani përkatës i Veprimit për Fëmijët i konsiderojnë fëmijët si një grup jashtëzakonisht vulnerabel. Objektiva dhe masa specifike në lidhje me arsimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve romë janë përfshirë në Strategjinë dhe në Planin përkatës të Veprimit për Komunitetin Rom. Në prill 2012 u miratuan gjithashtu Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve 2012-2015 dhe Plani përkatës i Veprimit. Përveç kësaj, një Urdhër i veçantë i Përbashkët i MB-së dhe i MPÇSSHB-së, që monitoron fenomenin e punës së fëmijëve, u lëshua në muajin gusht të vitit 2012.

Në prill dhe nëntor të vitit 2008, Parlamenti shqiptar miratoi ndryshimet në Kodin Penal dhe tashmë e konsideron veprën penale shfrytëzimin e fëmijëve dhe përdorimin e fëmijëve për materiale pornografike. Një Ligj integral mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve u miratua në nëntor 2010 dhe ndryshime të mëtejshme në Kodin Penal janë aktualisht duke u diskutuar.

QSH ka bërë përpjekje për krijimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve. Fillimisht, në vitin 2001 u krijua Komiteti Kombëtar Drejtues për eliminimin e Punës së Fëmijëve, i kryesuar nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i ndjekur nga krijimi i Komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve në mars të vitit 2007. Më tej, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve u krijua në vitin 2011 dhe një Njësi specifike Anti-trafik në MB. Më pas, 10 Njësi për të Drejtat

e Fëmijëve u krijuan në nivel rajonal⁴⁶ dhe 62 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve u krijuan në nivel Bashkie/Komune. Dy VKM⁴⁷ ofruan rregulla specifike për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit statistikor midis strukturave të ngjashme të qeverisë qendrore dhe vendore.

Gjatë vitit 2011, 84 viktima/viktima potenciale trafikimi⁴⁸ u identifikuan dhe u mbështetën nga Qendrat Rezidenciale, nga të cilët 39 ishin fëmijë. Një raport monitorues mbi progresin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve u përgatit nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në vitin 2012. Megjithatë, fëmijët e rrugës, puna e fëmijëve dhe dhuna psikologjike mbeten çështje me interes të veçantë, që kërkojnë vëmendje më sistematike nga autoritetet. Përveç kësaj, është mjaft e lehtë të vërehet se ka njëfarë konfuzioni në lidhje me numrin e dokumenteve strategjike dhe strukturave institucionale të përfshira në zbatimin dhe monitorimin e tyre. Ka shumë strategji dhe shumë struktura institucionale qendrore dhe vendore, me efektivitet dhe efikasitet të diskutueshëm.

Gratë rome

Strategjia Kombëtare mbi Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje dhe Plani përkatës i Veprimit u miratuan në vitin 2007. Një Ligj specifik mbi Barazinë Gjinore u miratua, gjithashtu, në korrik të vitit 2008 dhe një Njësi mbi Dhunën në Familje është krijuar pranë MPÇSSH-së. Në janar të vitit 2009 u krijua Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore. Në vitin 2010 janë krijuar pranë rajoneve të policisë njësi të posaçme për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje. Të gjitha dokumentet e mësipërme trajtojnë çështje të përgjithshme gjinore në Shqipëri, duke përfshirë gratë rome.

Megjithatë, dhuna në familje ende mbetet e përhapur dhe praktikisht mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës duhet të forcohet ndjeshëm. Sistemi funksional i asistencës për viktimat nuk është tërësisht profesional dhe ende mbështetet gjerësisht nga financimi i huaj.

Trafikimi i qenieve njerëzore

Komiteti Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është krijuar në vitin 2002, i kryesuar nga Ministri i Brendshëm.⁴⁹ Duke filluar nga viti 2005, pranë MB-së është vendosur Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Anti-Trafikimin. Kapaciteti administrativ i Zyrës është përmirësuar dhe institucioneve përkatëse në nivel lokal dhe kombëtar i është ofruar trajnim i specializuar. Një Urdhër Kryeministri për krijimin e Komiteteve Rajonale për Anti-Trafikimin është lëshuar në qershor 2006. Plani Kombëtar i Veprimit 2011-2013 për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore është miratuar në fillim të vitit 2011,⁵⁰ ndjekur nga miratimi i Procedurave Standarde për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit.⁵¹ Janë nënshkruar edhe Marrëveshje Bashkëpunimi me vende fqinje, si dhe kanë përfunduar marrëveshje me OJQ-të lokale dhe organizatat ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2011 Policia e Shtetit identifikoi 23 çështje penale të trafikimit të qenieve njerëzore, nga të cilat 17 për trafikim femrash, që përfshijnë 24 autorë (tetë prej tyre janë arrestuar), dhe gjashtë çështje për trafikim të fëmijëve, që përfshijnë 10 autorë (dy prej tyre janë arrestuar). Prokuroria regjistroi shtatë çështje të reja gjatë vitit 2011. Gjykata e Shkallës së Parë përfundoi 13 çështje, nga të cilat tre janë regjistruar gjatë vitit 2011. Gjykata e Apelit përfundoi 12 çështje dhe Gjykata e Lartë 17 çështje, nga të cilat 11 çështje për trafikim femrash dhe gjashtë çështje për trafikim fëmijësh.⁵² Megjithatë, Shqipëria

46 Njësitë e të Drejtave të Fëmijëve janë krijuar pranë Këshillit të Qarkut të çdo Rajoni.

47 VKM-të e lëshuara në prill 2012.

48 Nuk ka të dhëna specifike për komunitetet rome.

49 VKM Nr. 8, datë 5.01.2002.

50 Plani i Veprimit dhe dokumenti shtesë në lidhje me trafikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve janë miratuar nga VKM Nr. 142, datë 23.02.2011.

51 VKM Nr. 582, date 27. 07. 2011.

52 Koordinatori Kombëtar për Anti-Trafikimin, Raport për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Tiranë, shkurt 2012.


vazhdon të konsiderohet një vend burimi i trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht i grave dhe vajzave për shfrytëzim seksual. Fëmijët trafikohen gjithashtu për lypje dhe forma të tjera të punës së fëmijëve dhe rreth gjysma e viktimave shqiptare të trafikimit janë nën moshën 18 vjeç.⁵³ Kapaciteti zbulues ka mbetur i ulët dhe shumë pak raste trafikimi janë ndjekur penalisht.

3. ARSIMI

Diskriminimi në aksesin në arsim

Në Shqipëri nuk është e mundur as ofrimi i të dhënave standarde mbi arsimin e komunitetit rom, as identifikimi i objektivave të qartë të lidhura me arsimin. Nuk është i mundur, gjithashtu, edhe monitorimi i nivelit të të mësuarit të tyre, për shkak të mungesës të informacionit të mjaftueshëm sasior për popullsinë rome që jeton në Shqipëri. Si rezultat, mungojnë statistikatat zyrtare përkatëse nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Megjithatë, ekziston një perceptim i përbashkët se krahasimi midis nivelit të arsimit të komunitetit rom dhe popullsisë jo rome nxjerr në pah në mënyrë të pashmangshme se hendeku midis dy grupeve është shumë i thellë.

Figura 8.
Sipas mendimit tuaj, a është arsimi i nevojshëm për fëmijët tuaj?



Ndërsa pothuajse 100 për qind e familjeve rome do të dëshironin fuqimisht që fëmijët e tyre të mbaronin të paktën arsimin fillor,⁵⁴ vetëm pak prej tyre e konsiderojnë arsimin e fëmijëve të tyre të domosdoshëm.⁵⁵ Kjo lidhet me arsyet e mëposhtme kryesore:

- Perceptimi i tyre është se arsimi nuk lidhet drejtpërdrejt me punësimin dhe se arsimi nuk do të mund të zbusë varfërinë e tyre;
- Prindërit kanë nevojë për kontributin e fëmijëve në jetën e përditshme për shkak të varfërisë ekstreme dhe mungesës së punësimit;
- Prindërit nuk kanë besim se fëmijët e tyre mund të kenë aftësi minimale për përfundimin e arsimit fillor;
- Kushtet shumë të këqija të jetesës pengojnë kryerjen e detyrave të shtëpisë të fëmijëve dhe përbëjnë një pengesë të madhe për rezultatet pozitive të fëmijëve në shkollë;
- Pothuajse të gjithë prindërit janë analfabetë dhe nuk mund të ndihmojnë fëmijët e tyre për të bërë detyrat e shtëpisë; dhe
- Prindërit janë gjithë ditën jashtë shtëpisë, me qëllim që të gjejnë diçka për familjen e tyre, dhe askush nuk mund të kujdeset për fëmijët.

I HUAJ NË VENDIN TIM

Unë jam një studente rome në vitin e tretë të Fakultetit të Shkencave. Shokët e klasës sime ndodhen shpesh në vështirësi nga reagimi i njerëzve, kur ata më dallojnë nga ngjyra se jam një vajzë rome. Ju duhet të flisni në anglisht dhe ne do t'iu prezantojmë si braziliane-më pëshpërisin shokët në vesh. Për shkak të kësaj, shumë shpesh njerëzit në rrugë ose në transport publik mendojnë se jam e huaj. Dhe kur filloj të flas shqip, ata më shohin me dyshim dhe thonë se flas shqip shkëlqyeshëm. Shqiptarët ndihen më mirë të më pranojnë si të huaj sesa si një vajzë rome.

A.G. Tiranë

54 Arsimit bazë në Shqipëri është i detyrueshëm.


55 Rezultatet dhe diagramat bazohen në rezultatet e studimit të kryer në kuadër të këtij raporti.

Sipas opinionit të vlerësuesve, ekziston nevoja për një perceptim më të mirë dhe më të thellë të konceptit të përqendrimit në shkollës të fëmijëve romë në Shqipëri. Para së gjithash, ekziston një perceptim i përgjithshëm se as institucionet qeveritare, as komuniteti rom nuk janë në favor të ndarjes së shkollave. Çështja duhet të vlerësohet nga afër në lidhje me zonat e banimit të familjeve rome që mund të ishin kryesisht:

- Zonat urbane ose rurale ku jetojnë familjet rome në të njëjtat komunitete me familjet jo-rome;
- Zonat urbane me përqendrim të lartë të banorëve romë; dhe
- zonat periferike ose rurale, ku romët jetojnë në vendbanime tërësisht të ndara nga komunitetet jo-rome.

Ndarja e shkollave eliminohet tërësisht për grupin e parë dhe nxënësit romë regjistrohen në të njëjtat shkolla dhe në klasa të përziera me nxënës jo-romë. Në grupin e dytë, ndarja e shkollave eliminohet pjesërisht: në këto zona më shpesh ka shkolla bazë të dominuara nga nxënës romë për shkak të përqendrimit të lartë të banorëve romë. Kjo lidhet veçanërisht me ciklin e ulët (CU) të arsimit bazë⁵⁶ (shihni gjithashtu pikën 2.4.1). Në grupin e tretë është pothuajse i pamundur eliminimi i ndarjes, veçanërisht për arsimin parashkollor dhe për CU të arsimit bazë për shkak të largësisë së shkollave të përziera nga vendbanimi rom. Rasti i shkollës fillore në *Stani i Moraves*,⁵⁷ në afërsi të qytetit të Beratit, ku jetojnë 169 familje rome, është një rast tipik. Ekzistojnë vetëm dy klasa kolektive në këtë shkollë fillore (që përfshijnë përkatësisht klasën e parë dhe e të tretë dhe klasën e dytë dhe të katërt), me 35 nxënës në total dhe të gjithë nxënësit janë Romë pasi nuk ka familje jo-rome në këtë zonë. Kjo ndarje nuk ishte e mundur të shmangej pasi distanca afër shkollës më të afërme të përzier është e pamundur të përballohet nga nxënësit romë, veçanërisht gjatë dimrit. Si rezultat, u realizua kjo shkollë e vogël nëntëvjeçare në bazë të kërkesave të përsëritura nga vetë komuniteti rom. Kjo u shpjegua qartë për vlerësuesit si nga mësuesit e shkollës dhe nga përfaqësues të komunitetit rom.

Figura 9.
A ka raste kur fëmijët romë ndahen në klasa të veçanta?



Nuk janë të disponueshme të dhënat bazë mbi veçimin e fëmijëve romë në shkolla/klasa të ndara në krahasim me numrin total të fëmijëve romë të regjistruar në nivelin përkatës të arsimit. Si rezultat, mungojnë treguesit e matshëm nga pikëpamja sasiore për të vlerësuar nëse ndarja dhe numri i fëmijëve në shkolla/klasa të ndara është rritur apo është ulur. Megjithatë, në nivel vendor, DRA-të regjistrojnë informacione për kopshtet dhe shkollat fillore brenda zonave me përqendrim të lartë të familjeve rome.


Trajtimi diskriminues i fëmijëve romë në shkolla nuk njihet zyrtarisht, duke marrë parasysh se në përgjithësi ata janë të mirë-pranuar në të gjitha nivelet e arsimit. Megjithatë, ka shumë shembuj të raportuar nga nxënësit romë dhe nga vetë mësuesit që mund të tërhiqnin vëmendjen e institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë shqiptare në tërësi. Në disa raste, prindërit jo-romë i ndalojnë fëmijët e tyre që të qëndrojnë në të njëjtën bankë me nxënës romë, duke ndikuar gjerësisht në formimin e fëmijëve: nxënësit jo-romë për herë të parë kuptojnë se nxënësit romë nuk mund të jenë shokët e tyre dhe nxënësit romë kuptojnë për herë të parë se ata janë të ndryshëm nga të tjerët dhe nuk vlerësohen pozitivisht nga të tjerët. Ndërkohë, prindërit në këto raste janë tepër të ashpër me mësuesit dhe drejtorët e shkollave, kur këta këmbëngulin për mosndarjen e nxënësve.

56 Arsimit bazë në Shqipëri i korrespondon arsimit parësor që përfshin Klasifikimin Ndërkombëtar Standard të Arsimit, UNESCO 2011.

57 Shkolla fillore "Avdul Avdia" në komunën Otlak të Rrethit të Beratit.

Figura 10.

A ka informacion mbi historinë e komunitetit rom në tekstet shkollore?




Reforma e sistemit arsimor në Shqipëri ka sjellë ndryshime të dukshme cilësore në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e sistemit, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies. Megjithatë, deri tani, në tekstet shkollore nuk ka informacion mbi historinë dhe kulturën rome. Komuniteti rom është përmendur vetëm si një minoritetet lingvistik në pjesën e programeve mësimore të fokusuar në çështjet e të drejtave të njeriut dhe së bashku me minoritete të tjera etnike dhe lingvistike⁵⁸ pa ofruar informacione specifike për këtë komunitet.

DRA-të kanë ofruar trajnime të rregullta për mësuesit në lidhje me programet e reja mësimore dhe metodat e reja të mësimdhënies. Module specifike për mësuesit që kanë nxënës nga grupe vulnerabël dhe veçanërisht nxënës romë, janë përfshirë edhe në këto trajnime. Trajnime shtesë për mësuesit e nxënësve romë janë ofruar nga OJQ, me financim të agjencive të donatorëve ndërkombëtarë.

Figura 11.

A mendoni se historia e komunitetit rom duhet të përfshihet në tekstet shkollore?



Shqetësimet e BE-së për arsimimin e komunitetit rom në Shqipëri prezantohen sistematikisht në Raportet e Progresit të KE-së veçanërisht gjatë periudhës 2006-2012. Mungesa e aksesit në arsim,⁵⁹ niveli shumë i ulët arsimor dhe kualifikimi profesional,⁶⁰ nivelet e ulëta të regjistrimit në shkollë të fëmijëve romë,⁶¹ diskriminimi në lidhje me aksesin në arsim,⁶² niveli i lartë i braktisjes së shkollës⁶³ dhe niveli më i ulët i regjistrimit në sistemin parashkollor tek fëmijët romë në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë,⁶⁴ ⁶⁵ kanë qenë të metat kryesore të identifikuara nga KE në lidhje me arsimin e popullsisë rome. QSH, e angazhuar në zbatimin e MSA-së, ka ndryshuar sistematikisht strategjitë e saj përkatëse dhe kuadrin ligjor dhe/ose rregullator dhe ka bërë përpjekje për ta përmirësuar situatën. Megjithatë, aksesit i romëve në arsim vazhdon të vlerësohet në Raportet e Progresit si shumë i ulët.

58 Legjislacioni shqiptar njih tre minoritete kombëtare (greke, etnike maqedonase dhe malazese) dhe dy minoritete etnolingvistike (vllahë dhe romë).

59 Raport Progresi i KE-së – Shqipëria 2006.

60 Raport Progresi i KE-së – Shqipëria 2007.

61 Raport Progresi i KE-së – Shqipëria 2008.

62 Raport Progresi i KE-së – Shqipëria 2009.

63 Raport Progresi i KE-së – Shqipëria 2010.


64 Raport Progresi i KE-së – Shqipëria 2011.

65 Raport Progresi i KE-së – Shqipëria 2012.

Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë

Romët janë nga komunitetet me nivel më të ulët arsimor në Shqipëri. Niveli i tyre i analfabetizmit vlerësohet të jetë shumë i lartë, veçanërisht për gratë, në krahasim me nivelin e analfabetizmit të popullsisë jo-rome. Të dhëna empirike tregojnë se rreth 40 për qind e popullsisë rome janë analfabetë, në krahasim me 1.6 për qind të mesatares së vendit, ndërsa vitet mesatare të ndjekjes së shkollës janë 5.6 vjet për meshkujt dhe 5.3 vjet për femrat,⁶⁶ në krahasim me 8.6 vjet që llogaritet mesatarja e vendit. Megjithatë, edhe mesatarja e vendit kryesisht është në nivel të prapambetur në krahasim me vendet fqinje dhe është rreth gjashtë vjet më e ulët se mesatarja e vendeve të OECD-së.

Figura 12.
Përse regjistrimi i fëmijëve romë në arsimin bazë është shumë i ulët?



Pikënisja e nivelit të ulët arsimor mund të konsiderohej arsimit parashkollor, pasi fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor i përshtaten më mirë mjedisit shkollor, kur shkojnë në shkollë fillore, dhe përballen me më pak vështirësi në përvetësimin e njohurive të reja. Arsimit parashkollor është gjithashtu një lidhje e rëndësishme për të mësuar siç duhet gjuhën shqipe. Të dhëna empirike tregojnë se vetëm rreth 27 për qind e fëmijëve romë të moshës nga tre deri gjashtë vjeç frekuentojnë arsimin parashkollor. Në disa rrethe, si për shembull në Lezhë, Peshkopi, Shkodër, Kavajë dhe Peqin, arsimit parashkollor për fëmijët romë është pothuajse inekzistent. Në përgjithësi, sistemi ekzistues nuk është i aftë të mbulojë kërkesën: sipas të dhënave zyrtare, në vitin 2010 rrjeti i institucioneve parashkollore përfaqësonte 1,778 kopshte dhe regjistronte rreth 75,000 fëmijë.⁶⁷ Në disa zona me përqendrim të lartë të popullsisë rome, veçanërisht në vendbanimet periferike rome, sistemi parashkollor publik nuk ekziston, me përjashtim të disa kopshteve të realizuara nga agjencitë ndërkombëtare humanitare që ofrojnë transport, veshje dhe ushqim për të tërhequr dhe motivuar fëmijët romë për të ndjekur arsimin parashkollor.

Niveli i ulët arsimor lidhet me pengesat e mëposhtme kryesore:

- varfëria ekstreme konsiderohet si pengesa kryesore për arsimin bazë: shumica e familjeve rome nuk mund të përballojnë financiarisht arsimin e fëmijëve të tyre. Përveç kësaj, fëmijët romë vuajnë shpesh nga kequshqyerja dhe për pasojë kanë vështirësi përqendrimi për ndjekjen e orëve të mësimi;
- interesi shumë i ulët nga ana e prindërve romë: kjo ndodh kryesisht për shkak të gjendjes ekonomike të familjeve he nivelit të ulët të arsimimit të prindërve;
- një numër i madh familjesh rome janë të detyruara të zhvendosen nga një vend në tjetrin ose jashtë shtetit për arsye ekonomike. Si rezultat, është e vështirë që fëmijët e tyre të vazhdojnë studimet pas kthimit të tyre;
- largësia e shkollave nga shtëpia e tyre në disa zona specifike përfaqëson një pengesë të mundshme për fëmijët që të ndjekin shkollën, veçanërisht arsimin parashkollor dhe CU të sistemit të arsimit bazë për shkak të largësisë dhe pasigurisë që ndjejnë kur udhëtojnë në distancë të largët; dhe
- për arsye të tjera më pak të shpeshta të lidhura me trajtimin diskriminues të fëmijëve romë nga shokët e tyre jo-romë dhe nga mësuesit apo për shkak të pengesave gjuhësore.

66 CEES, Shpërndarja gjeografike e fëmijëve romë në Shqipëri, nëntor 2011.

67 MASH, Vjetari Statistikor, 2010.

Pengesa të tjera ndaj arsimimit lidhen me traditat kulturore rome (në lidhje me veçanërisht me gjininë, gjuhën dhe traditat boheme), të cilat janë, gjithashtu, pengesë të rëndësishme. Martesa në moshë të hershme e detyruar nga prindërit, veçanërisht për vajzat rome, është një prej pengesave të mësipërme. Kjo është arsyeja përse numri i vajzave rome të regjistruara në shkollë fillon të bjerë pasi ato përfundojnë CL të arsimit bazë. Përveç kësaj, prindërit i largojnë vajzat nga shkolla kur mbushin 12 ose 13 vjeç, për t'i parandaluar nga socializimi me djemtë.⁶⁸

Numri i fëmijëve romë që përfundojnë arsimin e detyrueshëm mbetet shumë i ulët. Mund të analizohen disa argumente por niveli shumë i lartë i braktisjes së shkollës mund të ishte një prej arsyeve kryesore. Fenomeni i braktisjes së shkollës është më i zakonshmi për ciklin e lartë (CL) të arsimit bazë. Mungesa e motivimit është arsyeja e përmendur më shpesh pse fëmijët romë braktisin shkollën. Kjo përkthehet në mërzë, pakënaqësi, perceptimi se çfarë ofron shkolla nuk lidhet me jetën e tyre aktuale, si dhe me aspiratat e tyre të ardhshme. Për të qenë të motivuar, fëmijët romë kanë nevojë për stimul, frymëzim, nxitje dhe entuziazëm që ndodh me fëmijët që i përkasin familjeve jo-rome. Ata gjithashtu kanë nevojë për shtysë, qëllim, vetëvlerësim dhe kuptim për të bërë diçka të vlefshme, gjë që klasat dhe mësimet kryesisht nuk arrijnë t'ia ofrojnë. Ndryshe, ata janë lehtësisht të predispozuar për ta braktisur shkollën: disa prej tyre përpara vitit të katërt të arsimit parësor, shumica gjatë ciklit të lartë. Përveç kësaj për, nuk ka udhëzime në gjuhën amtare për fëmijët romë, duke kontribuar në nivelet e larta të braktisjes së shkollës.

Pavëmendja e mësuesve për çdo nxënës individualisht mbetet gjithashtu një faktor kyç i braktisjes së shkollës. Në një sistem arsimor ku mësuesit, klasat dhe ambientet shkollorë janë të mbingarkuara dhe të pajisura si duhet, fëmijët romë shpesh shpërfillen në klasë dhe kalojnë nga viti në vit me arritje minimale të nxënies. Duke mos patur mbështetje shtesë, fëmijët romë shpesh shkëputen nga mësimet në klasë dhe në mënyrë të heshtur mbeten gjithnjë e më prapa megjithëse qëndrojnë brenda sistemit. Këta fëmijë eventualisht e braktisin shkollën dhe bashkohen me masat e nxënësve të arsimit bazë që braktisin shkollën.

Siç u përmend më parë (shihni pikën 4.2.3), interesi i prindërve për të nxitur fëmijët romë që të përfundojnë arsimin bazë mbetet shumë i pakët, kryesisht për shkak të nevojës së tyre për të angazhuar fëmijët në aktivitete ekonomike. Puna informale e fëmijëve dhe presioni i prindërve ndaj fëmijëve për të lënë shkollën mbetet i pranishëm në mënyrë të përhershme. Gjithashtu, kjo lidhet shpesh me traditën e përhapur të martesave të vajzave rome në moshë të vogël. Sipas rezultateve të një studimi të kohëve të fundit, rreth 19% e të gjithë fëmijëve (nga 6 deri 14-vjeç) në Shqipëri punojnë, 91% e fëmijëve (5-14-vjeç) ndjekin shkollën dhe 20.5% e fëmijëve (7-14-vjeç) kombinojnë punën dhe shkollën.⁶⁹ I njëjti studim thekson raportin e lartë të romëve në radhët e fëmijëve të rrugës dhe të viktimave të trafikimit.⁷⁰

Regjistrimi në arsimin formal dhe përfundimi i shkollimit nuk garanton nxënien dhe fenomeni i fshehur i largimit nga shkolla është shumë i pranishëm tek fëmijët romë. Shumë prej tyre nuk arrijnë të zotërojnë aftësitë bazë të leximit, shkrimit dhe aftësitë matematikore pas katër ose më shumë vitesh arsimit të detyrueshëm. Një arsye kryesore duket të jetë adresimi i mësimdhënies rreth të gjithë klasës në vend që tu kushtohet vëmendje grupeve të vogla apo të punohet individualisht me nxënësit. Duke qenë në radhët e nxënësve më të dobët, fëmijët romë humbin interesin tek mësimet dhe hyjnë në një gjendje shkëputjeje nga të mësuarit që mësuesit e patrajnuar ose të paangazhuar e tolerojnë-dhe madje inkurajojnë- për sa kohë që fëmijët nuk bëhen problematikë ose të pabindur. Këta nxënës nuk largohen nga shkolla fizikisht; ata janë të pranishëm statistikisht por jo të dukshëm në aspektin e të të mësuarit.

Programi i shancit dytë është miratuar nga MASH disa vjet më parë, duke caktuar mësues për kurse specifike për fëmijët romë, me qëllim që të plotësonin boshllëqet e tyre mësimore në arsimin bazë, për t'i inkurajuar ata të kthehen në shkollë dhe/ose për të parandaluar braktisjen e shkollës prej tyre. Pavarësisht nga mungesa e të dhënave sistematike statistikore për këtë program, perceptimi i përgjithshëm i të anketuarve romë është se ky program është mjaft i dobishëm dhe i suksesshëm dhe duhet të shtrihet në të gjitha shkollat, duke përfshirë një numër më të madh të fëmijësh romë.

68 PNUD, Një studim mbi vlerësimin e nevojave për komunitetet rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012.

69 Departamenti Amerikan i Punës, Rezultatet mbi Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve- Shqipëria, tetor 2010, fq 3.

70 Po aty, fq 10.

Arsimi i mesëm

Numri i studentëve romë të regjistruar në arsimin e mesëm të përgjithshëm është shumë i ulët. Kjo tregohet qartë nga Tabela 2, që përfshin të dhënat e grumbulluara në 10 rrethe.⁷¹ Kjo lidhet kryesisht me numrin shumë të ulët të fëmijëve romë që përfundojnë arsimin bazë për shkak të nivelit të ulët të ndjekjes së shkollës dhe nivelit të lartë të braktisjes së saj. Deri tani, të dhënat dhe treguesit përkatës statistikorë zyrtarë mungojnë dhe është mjaft e vështirë që ky fenomen të analizohet nga pikëpamja sasiore.

Në përgjithësi, arsimi dhe formimi profesional (AFP) nuk është një arsim i mesëm i preferuar në Shqipëri, gjë që tregohet qartë nga raporti i ulët i regjistrimit në krahasim me numrin total të nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm. Ndërsa mesatarja kombëtare e këtij raporti raportohet të jetë rreth 24% në krahasim me 40% të objektivit kombëtar për vitin 2013, vlerat për 10 rrethe të përzgjedhura duken të jenë mjaft më të ulëta, veçanërisht për fëmijët romë (shihni Tabelën 2). Kjo lidhet me dy arsye kryesore të mëposhtme:

- Ka një mungesë totale interesi të nxënësve romë për t'u regjistruar në AFP e treguar qartë në të dhënat e paraqitura në Tabelën 2;
- Pothuajse të gjithë nxënësit e zonave rurale nuk kanë akses në AFP pasi nuk ka shkolla profesionale në këto zona (me përjashtim të një numri shumë të kufizuar të pidentifikuar nxënësish nga fshatrat afër zonave urbane, ku ka shkolla profesionale). Kështu, fëmijët romë që jetojnë në zona rurale përjashtohen automatikisht nga AFP-ja.

Tabela 2: Të dhëna për arsimin e mesëm, 2011⁷²

Nr	Rrethi	Romët në arsimin e mesëm të përgjithshëm si % e numrit total të nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm	Niveli i regjistrimit në AFP, në krahasim me numrin total të nxënësve në arsimin e mesëm në %	Romët e regjistruar në AFP si % e numrit total të nxënësve në AFP
1	Elbasan	0	15.2	0
2	Gramsh	0	0	0
3	Librazhd	0	3.6	0
4	Peqin	0	0	0
5	Lezha	0	0	0
6	Kurbini	0	0	0
7	Mirdita	0	0	0
8	Fieri	0.1	7.3	0.4
9	Lushnja	0	8.2	0
10	Mallakastra	n.a.	0	n.a.

Sistemi i trajnimit publik profesional (TP) në Shqipëri përfshin 11 qendra TP që ofrojnë kurse trajnimi profesional pa pagesë dhe/ose me pagesë të plotë ose të pjesshme të tarifave të vendosura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP). Tabela 3 përfshin disa tregues specifikë për tre Rajone.⁷³ Ndërsa pjesa e punëkërkuësve të papunë të trajnuar në qendrat e TP mbetet përgjithësisht e ulët, pjesa e romëve të trajnuar në qendrat e TP është më e papërfillshme në krahasim me treguesin e përgjithshëm të papunësisë së popullsisë rome.

71 Nga 36 rrethe në total.

72 HDPC, ILO, Mbledhja e të Dhënave mbi Grupet Vulnerabil në Rrezik Përjashtimi nga Tregu i Punës, Tiranë, nëntor 2012.

73 Nga 12 rajone në total.

Tabela 3: Të dhëna mbi TP, 2011⁷⁴

Nr	Rajoni	Pjesa e personave të papunë të trajnuar në %	Pjesa e punëkërkuessve të trajnuar në %	Pjesa e romëve të trajnuar në %
1	Elbasan	46	23	4.5
2	Fier	23	23	14.5
3	Lezhe	0	0	0

Arsimi universitar

Numri i studentëve romë të regjistruar në universitetet publike dhe private mbetet shumë i ulët. Kjo lidhet me arsyet e mëposhtme kryesore:

- Numri i nxënësve romë që përfundojnë arsimin dytësor është shumë i ulët;
- si rezultat i pengesave të shumta, niveli i nxënies së nxënësve romë të shkollave të mesme është përgjithësisht më i ulët;
- familjet rome kanë tendencën të mos e mbështesin arsimimin universitar, duke marrë parasysh të ardhurat e munguara nga fëmijët e tyre në rast se do të vazhdojnë mësimet;
- familjet rome nuk janë në gjendje të përballojnë tarifatat universitare ose shpenzime të tjera përkatëse për fëmijët e tyre; dhe
- ka pak informacion mbi programet e bursave për studentët romë të nivelit universitar.

Me qëllim kapërcimin e pengesave ekonomike financiare, në vitin 2008 Fondi i Arsimit Rom i ofroi Shqipërisë programin e bursave të arsimit të lartë. Për vitin e parë akademik 2008-2009 u paraqitën vetëm katër aplikime për Programin e Bursave Universitare “Roma Memorial” dhe të gjitha kërkesat u miratuan. Gradualisht, çdo vit numri i aplikimeve dhe bursave të dhëna është rritur: në vitin aktual akademik 2012-2013 u paraqitën 62 aplikime nga të cilat 37 u miratuan dhe përfituan bursa.⁷⁵

74 HDPC, ILO, Mbledhja e të Dhënave mbi Grupet Vulnerabil në Rrezik Përrjashtimi nga Tregu i Punës, Tiranë, nëntor 2012.

75 Fondi i Arsimit Rom, Vlerësim Vendi, Shqipëria, 2011.


4. PUNËSIMI

Punësimi – shqetësimi kryesor

Sipas studimit tonë, punësimi/papunësia është shqetësimi kryesor i komunitetit rom në Shqipëri, që duhet të zgjidhet me prioritet. Kjo lidhet drejtpërdrejt me varfërinë ekstreme të familjeve rome dhe kushteve të tyre shumë të këqija të jetesës. Varfëria në rritje krijon një rreth vicioz për ta: sa më të varfër të bëhen, aq më e vështirë është të gjendet punësim formal dhe informal. Megjithatë, mungojnë të dhënat përkatëse statistikore për tregun e punës dhe marrëdhënia e tij me varfërinë. Në mungesë të të dhënave formale, disa pyetje u përfshinë shprehimisht në pyetësin e vrojtimit të kryer në kuadër të këtij raporti.

Figura 13.

Cilat janë shqetësimet kryesore të komunitetit rom që duhet të zgjidhen me prioritet shumë të lartë?



350 familjet e intervistuar sipas këtij vrojtimi përbëheshin mesatarisht nga 6.2 pjesëtarë për familje. Nga këta, mesatarisht vetëm 0.8 persona për familje rezultuan të jenë të punësuar formalisht ose informalisht. Anëtarët e tjerë të familjeve ishin fëmijë ose të rritur të papunë. Të ardhurat mesatare mujore për person në familjet e intervistuar rezultuan të ishin 1,356 LEK. Kjo shumë i korrespondon të ardhurave ditore prej 45 LEK për person ose rreth 0.44 USD për person në ditë. Ky është një argument i qartë përse punësimi konsiderohet kaq i rëndësishëm për familjet rome.

Historia e punësimit të komunitetit rom që jeton në Shqipëri është shumë e thjeshtë dhe tradicionale: gjatë periudhës së sistemit të mëparshëm Romët punësoheshin në bujqësi, në ndërmarrje shtetërore artizanale dhe në punë të shërbimit publik si pastrimi i rrugëve dhe lulishtaria. Gjatë tranzicionit shumë romë hasën vështirësi për t'iu përshtatur kërkesave të reja të tregut të punës pasi iu mungonin shumë prej kualifikimeve të kërkuara dhe ekspertiza profesionale. Ata janë tashmë të angazhuar në disa forma të punës formale dhe informale. Punësimi formal dominohet nga bujqësia për të mbijetuar për shkak të parcelave shumë të vogla të tokës, mungesës së infrastrukturës dhe ujitjes, kostove të larta të punës dhe konkurrencës së lartë nga prodhime të importuara bujqësore. Përveç kësaj, shumë familje rome nuk kanë patur përfitime nga shpërndarja e tokës pas reformës së tokës në fillim të viteve 90. Biznesi i rrobave të përdorura është gjithashtu një burim kryesor i

NUK ZOTËROJMË AS NJË COPË TOKË, AS LUMIN!


Jemi shumë më keq sesa në regjimin e mëparshëm. Përpara viteve 90 gaxhitë kishte tokë, ne kishim lumin. Gaxhitë punonin tokën dhe jetonin me të. Ne përdornim shelgjet dhe jetonim me punë artizanale. Pas viteve 90 shteti i dha gaxhive tokë. Ne nuk përfituam asnjë parcelë toke në pronësi. Shteti nuk na dha as lumin. Gaxhive iu dha lumi dhe pronarët nuk na lejonin të punonim me shelgje. U lamë tërësisht pa asnjë mundësi punësimi. Nuk bëjmë punë tjetër, nuk dimë të bëjmë punë tjetër. Duhet shumë vite që ne të kemi një traditë të re punësimi. Edhe kur ndjekim ndonjë trajnimi, ne jemi më të interesuar të thurim shporta.

A. A. Gjirakster

të ardhurave për shumë familje rome, pavarësisht nga rënia e tregut të rrobave të përdorura gjatë viteve të fundit për shkak të një kërkese më të ulët, varfërisë dhe konkurrencës.

Punësimi informal afatshkurtër dominohet nga punë të përkohshme ose të rastësishme, si për shembull ndërtimi, thurja e shportave, punimet me metal ose kujdesi për kuajt, si dhe nga performanca muzikore në dasma dhe ceremoni të tjera festive, tregtia artizanale dhe lypja në qytete dhe fshatra, ku shumica e lypësve janë gra ose fëmijë deri në moshën 12 vjeç, të cilët lypin për para, rroba të përdorura dhe ushqime. Puna e rastësishme përfaqëson një mundësi shumë të rëndësishme për romët pasi lehtëson ndikimet e niveleve të larta të papunësisë dhe rrit të ardhurat familjare, duke vendosur kështu një amortizator social të përkohshëm.

Figura 14.
Përse niveli i papunësisë së komunitetit rom është kaq i lartë?



Aktualisht, shumë romë nuk janë të aftë të gjejnë punë. Perceptimi i tyre është se gjendja e tyre e punësimit është më e rënduar sesa në regjimin e mëparshëm. Shumë arsye për papunësinë masive dhe afatgjatë të komunitetit rom mund të përfshinin: (i) Mungesën e aftësive profesionale: kualifikimet arsimore dhe profesionale të romëve janë ulur gjatë tranzicionit dhe përgjithësisht mbeten të ulëta në krahasim me ato të shqiptarëve; (ii) Mungesën e mundësive për shkak të ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe përshtatjes së pamjaftueshme me nevojat e reja të tregut të punës: Pavarësisht nga këto ndryshime strukturore, romët vazhdojnë të ushtrojnë profesionet e tyre tradicionale për të jetuar dhe si rezultat, shumë romë janë tashmë të papajisur për të plotësuar kërkesat e reja të tregut formal të punës; (iii) Diskriminimin nga punëdhënësit: preferencat e tyre parësore për punësim i janë drejtuar personave jo-romë; dhe (iv) Mungesën e politikave specifike shtetërore për trajtimin e çështjeve të papunësisë të komunitetit rom.

Politikat për nxitjen e punësimit


Politikat qeveritare për trajtimin e çështjeve të papunësisë në Shqipëri nuk synojnë specifikisht popullsinë rome. Nga QSH janë miratuar programet e mëposhtme kryesore publike për nxitjen e punësimit:

- i) *Mbështetja për punëkërkuarit e papunë në vështirësi:*⁷⁶ Sipas këtij programi, punëdhënësit ofrojnë punësim për punëkërkuarit për të paktën një vit, duke marrë deri 100% të pagës minimale për katër muaj dhe rimbursohen për 100% të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Përfituesit janë persona të papunë afatgjatë, njerëz që marrin asistencë sociale, persona që marrin përfitime nga papunësia, persona të moshës 18-25 vjeç që hyjnë në tregun e punës, persona mbi 45 vjeç që nuk kanë arsim më të lartë se arsimi i mesëm ose ekuivalenti i tij, persona me aftësi të kufizuara, romë dhe emigrantë të kthyer;

- ii) *Trajnimi gjatë punës për punëkërkuessit e papunë.*⁷⁷ Sipas këtij programi, punëdhënësve që ofrojnë trajnim gjatë punës për punëkërkuessit e papunë u ofrohet mbështetje financiare në formën e kostos së trajnimit (deri në 70% të kostos). Përveç kësaj, punëkërkuessit që ndjekin trajnime përfitojnë 50% të pagës minimale për të gjithë kohëzgjatjen e trajnimit. Ky program nuk i drejtohet grupeve të synuara specifike;
- (iii) *Gratë e papuna.*⁷⁸ Sipas këtij programi, punëdhënësit që ofrojnë punësim për gratë e marzhinalizuara punëkërkuessit, marrin 100% të pagës minimale për katër muaj dhe 70% të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Në rast të kontratave dy vjeçare, punëdhënësit marrin pagë minimale për 6 muaj dhe 85% të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Në mënyrë të ngjashme, në rastin e kontratave tre vjeçare punëdhënësit marrin pagë minimale për katër muaj dhe 100% të pjesës së tyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Financimi i këtij programi nga buxheti i shtetit përfundonte në vitin 2010. Më pas, MPÇSSHB përcaktoi grupet e synuara të përfshira në gratë e marzhinalizuara:⁷⁹ gratë e ish-trafikuar, gratë mbi 35 vjeç, gratë rome, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë e divorcuara. Në vitin 2012, QSH zgjeroni numrin e grupeve të synuara,⁸⁰ duke përfshirë edhe gratë e papuna prej një kohe të gjatë, gratë mbi 50 vjeç dhe gratë e kthyer nga emigrimi.

Figura 15.

A ekzistojnë politika specifike qeveritare që nxisin punësimin e komunitetit rom?



Një prej rezultateve më të rëndësishme nga analizimi i programeve të mësipërme të nxitjes së punësimin të miratuara nga QSH, është parakushti që përfituesit të regjistrohen si punëkërkuessit të papunë në zyrat vendore të SHKP-së. Ndërsa niveli i papunësisë së komunitetit rom llogaritet të jetë shumë i lartë, numri i romëve të regjistruar është shumë i ulët dhe shumë prej romëve të papunë nuk janë të regjistruar. Anëtarët e komunitetit rom pranojnë se arsyeja kryesore është se ata nuk besojnë se asistenca e SHKP-së do të rrisë mundësitë e tyre për punësim. Arsye të tjera mund të merren gjithashtu në konsideratë:

- Informacion shumë i kufizuar mbi procedurat dhe kriteret e regjistrimit: romët nuk janë të familjarizuar me procedurat administrative dhe komunikimi i tyre me administratën vendore është në përgjithësi i pamjaftueshëm. Nga ana tjetër, administrata vendore nuk është specifikuessit dhe fokusuar në ndihmën për popullsinë rome mbi mënyrën sesi të shpallen punëkërkuessit;
- Shumë familje rome zhvendosen nga një vendbanim në tjetër, kryesisht për arsye ekonomike; dhe
- Çështja e përhershme e mosregjistrimit të romëve në Zyrën e Gjendjes Civile përfaqëson një pengesë të madhe për regjistrimin e tyre si punëkërkuessit.

77 VKM Nr. 47, datë 16.01.2008.

78 VKM Nr. 632, datë 18.09.2003.

79 Udhëzim i MPÇSSHB-së, Nr. 76, datë 14.01.2004 "Mbi zbatimin e VKM-së Nr. 632".

80 VKM Nr. 27, datë 11.01.2012.

Tabela 4: Të Dhëna të Tregut të Punës⁸¹

No	Produktet	2007	2008	2009	2010	2011
1	Punëkërkuessit e papunë (totali)	142,871	141,700	144,766	142,761	143,002
2	Të punësuar nga SHKP (totali)	10,261	12,611	11,907	12,317	12,749
2.1	Nga të cilët: Programi i Nxitjes së Punësimit	2,100	2,188	2,020	1,757	1,170
2.2	Nga të cilët: romët	51	13	36	135	140
3	Numri total i personave të trajnuar në qendrat TP	7,029	7,577	6,611	8,485	8,531
	Nga të cilët: romë					

Të dhënat zyrtare statistikore (shihni Tabelën 4) konfirmojnë se numri i romëve të punësuar me asistencë të SHKP-së është tepër i papërfillshëm: mesatarisht 75 punëkërkuessit romë të punësuar në vit. Kjo është në përputhje me perceptimin e romëve mbi mbështetjen e ulët të ofruar nga zyrat vendore të SHKP-së. Përveç kësaj, një numër shumë i ulët i romëve ka ndjekur kurse të formimit profesional të ofruara nga qendrat e TP – mesatarisht 102 persona në vit në total – kjo konsiderohet si pasojë e drejtpërdrejtë e mosregjistrimit si punëkërkuessit. Më tej, vetëm rreth 9% e punëkërkuessit të papunë të trajnuar në qendrat e TP rezultoi të ishte punësuar pas trainimit. Si rezultat, mesatarisht vetëm 46 romë të papunë në vit janë punësuar pas përfundimit të kurseve të formimit profesional.

Figura 16.

A keni ndonjë mundësi për të hapur biznes me qëllim që të jeni i vetëpunësuar?





Figura 17.

Nëse jo, cilat janë pengesat kryesore?



Në përgjithësi, komuniteti rom nuk është i informuar mbi nevojën e regjistrimit si punëkërkuessit dhe se në ç'masë ky fakt do të ndikojë negativisht në çështje të tjera të rëndësishme për ta si përfitimet nga papunësia, ndihma sociale, librezat e kujdesit të tyre shëndetësor etj. Institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, OJQ-të lokale dhe aktivitete të donatorëve ndërkombëtarë nuk fokusohen mjaftueshëm në ndërgjegjësimin e komunitetit rom në lidhje me regjistrimin në zyrat vendore të SHKP-së.

Mundësitë që romët të hapin një biznes, me qëllim vetëpunësimi, janë shumë të kufizuara. Kjo u pranua nga shumica e romëve të intervistuar që rendisnin arsyet e mëposhtme:

81 Burimi: bazuar në "Statistika në vite", SHKP, 2012.

- Mungesa e financimit konsiderohet si pengesa kryesore, pasi bankat nuk ofrojnë kredi pa kolateral, ndërkohë që shumica e romëve nuk kanë tituj pronësie;
- Mungesa e njohurive mbi mënyrën e ngritjes së një biznesi dhe gjetjes së financimit është gjithashtu pengesë kryesore dhe kjo lidhet ngushtë me nivelin shumë të ulët arsimor të komunitetit rom;
- Zhvillimi i pamjaftueshëm i partneritetit midis bizneseve rome dhe jo-rome për shkak të qëndrimit diskriminues të jo-romëve përfaqëson një pengesë të konsiderueshme në mbijetesën e bizneseve rome, duke marrë parasysh se ky partneritet është i nevojshëm për zhvillimin e biznesit.

Përfitimet nga papunësia

Në Shqipëri, familjet që nuk kanë asnjë të ardhur nga aktivitetet ekonomike, programet e ndihmës sociale ose dërgesat nga anëtarë familjeje që punojnë jashtë shtetit, kanë të drejtën të përfitojnë nga programet e asistencës sociale. Këto programe kryesisht përfshijnë pagesën e papunësisë dhe ndihmën ekonomike (NE). Në përgjithësi, shumica e komunitetit rom është përjashtuar nga marrja e llojeve të ndryshme të NE-së ose nga marrja e kësaj ndihme për aq kohë sa është e nevojshme.

Dy kriteret kryesore për punëkërkuessit e papunë për marrjen e përfitimeve nga papunësia janë:

- Regjistrimi i tyre në zyrën vendore të SHKP-së: shumë romë të papunë nuk janë regjistruar si punëkërkuess (shihni pikën 5.2.2); dhe
- Pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore para papunësisë për një periudhë prej të paktën 12 muajsh: shumë romë të papunë kanë qenë të papunë prej një kohe të gjatë ose nuk janë punësuar asnjëherë formalisht, pra nuk kontribuojnë për planet e tyre të sigurimeve shoqërore pasi nuk mund të përballojnë pagesën. Si rezultat, shumë romë të papunë nuk kualifikohen për përfitime nga papunësia dhe një numër shumë i vogël i tyre (të llogaritur nga 0.3⁸² në maksimumi 2%)⁸³ marrin përfitime nga papunësia.

Qeveria ofron ndihmë ekonomike për familjet e varfra të përzgjedhura që jetojnë në zona urbane zakonisht marrin ndihmë të plotë ekonomike dhe në zonat rurale përgjithësisht marrin ndihmë të pjesshme ekonomike. Buxheti vjetor i ndihmës ekonomike planifikohet nga qeveria qendrore për secilën njësi shqiptare administrative dhe madhësia e ndihmës financiare varet nga numri i familjeve të pranueshme. Pagesa e shumës mujore për familjet shumë të varfra nuk i plotëson nevojat e tyre të përditshme.

Aktualisht, një numër i madh romësh është përjashtuar nga marrja e ndihmës ekonomike ose nga marrja e kësaj ndihme për sa kohë që është e nevojshme. Kjo lidhet kryesisht me disa prej kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara nga institucionet qeveritare:

PAS EMIGRIMIT, PA PËRFITIME TË NDIHMËS EKONOMIKE!

Jemi 13 persona në familje dhe askush nuk punon. Nuk kemi të ardhura ose ndihmë ekonomike. Jemi rropatur për dhjetë vjet fshatave të Greqisë, kemi jetuar me ç'të mundnim, kemi punuar si kafshë por në fund u kthyem në një gjendje më të keqe, në krahasim me kushtet që jetonim kur u larguam. Nuk ka asnjë lloj pune këtu. Ishim 5 persona në familje kur u larguam. Tani jemi 13 persona, u martuam dhe lindëm fëmijë. Askush nuk na përfill këtu. Kur u kthyem, barraka që kishim lënë nuk ishte më dhe ishte ndërtuar një godinë e re. E ndërtuam vetë këtë barrakë në periferi dhe jetojmë të gjithë së bashku në një "dhomë". Nuk përfitojmë nga Ndihma Ekonomike pasi sollëm nga Greqia një makinë larëse dhe një televizor me ngjyra. Ato i kam gjetur në plehra, nga ato që njerëzit i hidhnin. Këtu na thonë se nëse kemi një makinë larëse ose televizor, nuk mund të marrim Ndihmë Ekonomike. Beni, fqinji im, solli një makinë nga Greqia, një makinë të vjetër rrangallë. Duhet e gjithë lagjia për ta shtyrë makinën që të ndizet. Ai nuk përfiton Ndihmë Ekonomike pasi zotëron një makinë. Nëse dikush shkon në Greqi për të lypur, ata e ndërpresin menjëherë Ndihmën Ekonomike pasi ju jeni "turistë" dhe keni të ardhura. Djali im më i madh është 19 vjeç, ai është i pamartuar dhe i papunë. Ai nuk merr ndihmë ekonomike pasi është i pamartuar. Kur jemi të pamartuar, na thonë se nuk përfitojmë pa qenë më parë të martuar. Kur martohemi, na thonë se përse jemi martuar aq herët. Nuk mund të ketë më keq se kaq.

Iliri, 36 vjeç, Gjirokastër

82 PNUD, Studim mbi vlerësimin e nevojave për komunitetet rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012.

83 HDPC, ILO, Mbledhja e të Dhënave për Grupet Vulnerabil në Rrezik Përjashtimi nga Tregu i Punës, Tiranë, nëntor 2012.

- Pranueshmëria për ndihmën financiare kushtëzohet nga prania aktuale e kryefamiljarit mashkull në zyrat vendore të sigurimeve shoqërore për mbledhjen e përfitimeve mujore. Megjithatë, në shumë raste punësimi afatgjatë në Shqipëri i detyron shumë romë të varfër të emigrojnë jashtë shtetit ose në rajone të tjera shqiptare për të punuar dhe shumica e tyre duhet të mbeten aty për periudha të gjata kohe;
- Aktualisht, vetëm ata të papunë për më pak se një vit mund të marrin përfitime. Megjithatë, për shkak se papunësia afatgjatë është një gjendje e vazhdueshme në komunitetet rome, përfitimet humbin përpara se familjet të mund të kenë ndonjë lloj punësimi të qëndrueshëm;
- Ligji përcakton se përfituesit duhet të jenë regjistruar në një adresë të caktuar që nga viti 1993 ndërsa shumë familje rome u zhvendosën në fillim të viteve 90, duke u bërë kështu të papranueshëm për ndihmë ekonomike sipas këtij kriteri; dhe
- Krite të tjera të pranueshmërisë janë raportuar se janë zbatuar nga MPÇSSHB jo në përputhje me realitetin rom.

5. KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi i pamjaftueshëm shëndetësor

Në Shqipëri është e vështirë të gjenden të dhëna zyrtare mbi gjendjen shëndetësore të komunitetit rom. Sidoqoftë, është e sigurt që gjendja shëndetësore është përkeqësuar më shumë sesa për pjesën tjetër të popullsisë gjatë periudhës së tranzicionit.⁸⁴ Të dhënat empirike⁸⁵ tregojnë se në përgjithësi, sëmundje kronike si ato kardio-vaskulare, reumatizma, diabeti dhe sëmundjet neurologjike dhe psikiatrike janë të përhapura tek popullsia rome. Raste të tuberkulozit, sifilizit, hepatitit B dhe HIV/SIDA janë më të shpeshta tek romët sesa tek popullsia jo rome. Përveç kësaj, një pjesë më e madhe e familjeve rome ka anëtarë që vuajnë nga aftësia e kufizuar.⁸⁶ Përveç faktorëve socio-ekonomikë dhe kulturorë, kjo situatë ka ndodhur kryesisht për shkak të aksesit të pamjaftueshëm në kujdesin shëndetësor, që lidhet vecanërisht me cilësinë dhe përballueshmërinë financiare të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Fëmijët dhe gratë rome janë grupet e synuara më të prekura nga kujdesi i pamjaftueshëm shëndetësor. Ky fakt konfirmohet nga niveli më i lartë i vdekshmërisë dhe probleme më të mëdha në gjendjen shëndetësore të grave rome shtatzëna, si dhe parregullsitë në ndjekjen e kontrolleve shëndetësore dhe garantimin e vaksinimit të fëmijëve, veçanërisht në zonat rurale. Faktorët socio-ekonomikë, duke përfshirë veçanërisht nivelin e ulët kulturor dhe arsimor, nivelin shumë të lartë të papunësisë, mungesën e burimeve kryesore ekonomike, kushtet shumë të këqija të jetesës, moshën shumë të re të martesës dhe lindjes së fëmijës së parë, janë disa prej faktorëve kryesore që kontribuojnë në këtë situatë. Shumë familje rome jetojnë në barraka, tenda ose shtëpi të vjetra, ku infrastruktura e nevojshme mungon, ose në banesa që nuk kanë sisteme të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm. Mungesa e ujit dhe tualeteve në disa vendbanime bën që fëmijët të mos kenë higjienë personale dhe kjo është një nga arsytet për përhapjen e infeksioneve. Kequshqyerja dhe dieta shumë e varfër zakonisht e karakterizuar nga konsumimi i parregullt i ushqimit dhe ushqyerja e pabalancuar janë, gjithashtu, faktorë që shkaktojnë situatën e keqe shëndetësore të komunitetit rom.

Nga ana tjetër komuniteti rom deklaron qartë se ndihet i diskriminuar hapur nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore në krahasim me popullsinë jo-rome. Kjo nuk lidhet vetëm me problemet e zakonshme të shoqërisë shqiptare si mitmarrja nga mjekët ose infermierët. Kjo lidhet me shumë shembuj të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të deklaruar nga romët. Diskriminimi ndikon negativisht në komunikimin e tyre me ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, i shkurajon ata që të adresojnë menjëherë problemet e tyre shëndetësore dhe ndikon negativisht në përpjekjet e jashtëzakonshme të bëra nga OJQ-të për të rritur ndërgjegjësimin, në mënyrë që ky komunitet të ndjekë rregullisht kontrollet shëndetësore si mënyra më efçente për parandalimin e sëmundjeve, uljen e pasojave të sëmundjeve kronike dhe mbrojtjen e fëmijëve të tyre.

TË DISKRIMINUAR HAPUR!

Ne diskriminohe mi nga personeli i sektorit shëndetësor. Ju mund të mendoni se ne diskriminohe mi në mënyrë të fshehtë; në të kundërt, kjo ndodh hapur. Sa na shohin tek pragu i derës, mjekët dhe infermierët na dëbojnë pasi e dinë që nuk kemi as librezë të sigurimit shëndetësor, as para për ti dhënë nën dorë. Vetëm romët e bardhë mund të përfitojnë, pasi nuk dallohen si romë nga ngjyra e tyre, si pasojë nuk dëbohen. Ne jemi të nëpërkëmbur në çdo hap që hedhim. Kur gruaja ime po lindte, më thanë të dhuroja gjak, ndryshe nuk do të më jepnin certifikatën e lindjes të foshnjës sonë. Kështu, u largova. Edhe sot djali ynë nuk është i regjistruar pavarësisht se tani është tre vjeç.

J.B. – 24 vjeç

84 De Soto, H., Gedeshi, I., Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri, Banka Botërore, 2005.


85 PNUD, Studim i vlerësimit të nevojave mbi komunitetet rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012.

86 Po aty.

Ndërsa romët janë më pak të shqetësuar rreth shkeljes të të drejtës së tyre për informacion mjekësor⁸⁷ dhe konfidencialitetit brenda kujdesit shëndetësor, ata zbulojnë qartë nëpërmjet shembujve problemet e tyre në lidhje me shkeljen e të drejtave të më elementare të pacientëve, duke filluar nga: trajtimi i duhur pa paragjykim nga mjekët dhe infermierët. Përveç kësaj, ata kanë pak informacion mbi mekanizmat ekzistues për ankimin dhe rregullimin e shkeljeve. Ata madje ndihen të shkurajuar dhe nuk besojnë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Figura 18.

A ndjeni diskriminim në shërbimin shëndetësor të ofruar ndaj jush në krahasim me popullsinë jo-rome?



Nga pikëpamja institucionale, koordinimi midis sektorit të kujdesit shëndetësor dhe sektorëve të tjerë përkatës si arsimit, strehimi dhe punësimi në lidhje me kujdesin shëndetësor për romët, është përgjithësisht i pamjaftueshëm dhe nuk ka mekanizma operacionale që mund të nxisin këtë koordinim. Kjo lidhet veçanërisht me koordinimin midis institucioneve të qeverisë qendrore dhe atyre të qeverisjes vendore.

Çështja e sigurimit shëndetësor

Në përgjithësi, qendrat shëndetësore në fshatra dhe qytete nuk janë larg vendbanimeve rome dhe shumica e të anketuarve romë në studim pohon se aksesit i tyre në qendrat shëndetësore nuk përfaqëson për ta një shqetësim madhor në terma gjeografikë. Problemi i tyre kryesor është mungesa e Librezave të Sigurimeve Shëndetësore (LSSH). Sipas studimit tonë, vetëm një në pesë të anketuar romë konfirmon të ketë LSSH. Kjo situatë lidhet me disa arsye:

- Varfëria e familjeve rome që përgjithësisht nuk mund të përballojnë pagesën e kontributeve të tyre të sigurimeve shëndetësore;
- Shumica e romëve nuk paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore pasi ose janë të papunë, ose punojnë në tregun informal apo punë të rastësishme, ose janë të vetëpunësuar⁸⁸ (megjithëse pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore është parakusht për lëshimin e LSSH). Disa studime tregojnë se rreth 93% e romëve nuk paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore,⁸⁹ gjë që çon në papranushmërinë e tyre për skema të ndryshme të mirëqënies sociale, përfshirë LSSH;
- Shumë prej këtyre individëve romë punojnë pa kontratë të vlefshme punësimi dhe për rrjedhojë, nuk paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore. Të dhënat tregojnë se rreth 96% e romëve që punojnë nuk kanë kontrata punësimi;⁹⁰
- Disa prej familjeve rome nuk janë të informuara mbi procedurat që duhet të ndiqen për tu pajisur me LSSH; dhe (v) Një pjesë e vogël e familjeve rome nuk është e interesuar të pajiset me LSSH.

Në zonat urbane, dhënia e LSSH-ve lidhet me pagesën mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore që shoqërohet me pagimin e taksave. Kjo mund të realizohet:

87 Në përgjithësi, ata mendojnë se këto shkelje janë më pak të rëndësishme për ta sesa forma të tjera të shkeljeve.

88 Personave të papunë u kërkohet të paguajnë një shumë mujore të menjëhershme- si vetë-kontribut i sigurimeve shoqërore, me qëllim që të përfitojnë LSSH dhe pagesë pensioni pas daljes në pension.

89 De Soto, H., Gedeshi, I., Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri, Banka Botërore, 2005.

90 Po aty.

- Drejtpërdrejt nga ndërmarrja në rast se punëmarrësit romë janë punësuar me kontrata të rregullta. Në këtë rast, shumica e kontributit paguhet pjesërisht nga punëdhënësi dhe pjesërisht nga punëmarrësi;
- Me kontribut vullnetar nga individët e papunë. Në të dyja rastet romët penalizohen duke u privuar nga LSSH pasi vetëm pak prej tyre kanë kontrata të rregullta dhe nuk mund të përballojnë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore me paratë e tyre. Si rezultat, të dyja rastet konsiderohen të papërshtatshme nga romët.

Figura 19.

A keni librezë të sigurimit shëndetësor?





Figura 20.

Nëse jo, për cilat arsye?



Në zonat rurale dhënia e LSSH shoqërohet me pagesën e taksës së tokës, që është mjaft e lartë për shumë familje rome dhe nuk paguhet nga ata për shkak të varfërisë. Si rezultat, shumë individë romë në këto zona nuk janë të pajisur me LSSH.

Të gjithë romët, duke përfshirë ata që kanë LSSH, përveç pagesave informale për mjekët dhe personelin tjetër mjekësor, përballen me një pengesë të pakapërcyeshme në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor: koston e lartë e shërbimeve mjekësore dhe medikamenteve që për shumë familje rome janë të vështira për t'u përballuar. Këto kosto i shtohen pagesave informale për mjekët dhe personelin tjetër mjekësor. Romët

NUK KA LIBREZA TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR!

Ne duhet të paguajmë për shëndetin tonë; me para në dorë, ndryshe nuk na afrohet askush. Duhet të paguajmë për vizitën tek mjeku, të paguajmë medikamentet, shtrimin në spital, infermierën, pastrimin, të gjitha. Por ne nuk kemi të ardhura pasi nuk punojmë, nuk jemi të punësuar. Ku mund t'i gjejmë paratë? Le të marrim borxh. Nëse na jepen, duhet të punojmë me vite që t'i shlyejmë por askush nuk na jep më. Zgjidhja? Nuk shkojmë tek mjekët, nuk blejmë medikamente. Vetëm kur ndjejmë që fëmijët po vuajnë, jemi të detyruar të marrim hua. Ne jetojmë vetëm për fëmijët tanë. Nëse duhet të sakrifikojmë, nuk ia vlen. Një prej arsyeve është se duhet të kemi librezë të sigurimit shëndetësor. Me qëllim që të kemi librezë të sigurimit shëndetësor, duhet të jemi të punësuar ose të paguajmë për të çdo muaj në zyrën e sigurimeve. Nuk kemi as punë, as para, pra nuk kemi librezë. Të paktën fëmijët duhet ta kenë. Ata mund të kryejnë një vizitë falas tek mjeku i repartit por kur duhet t'i nënshtrohen analizave ose mjekimeve specifike, prindi duhet të paguajë. Përveç kësaj, fëmijët janë të pargjistruar. Gjithësesi, jemi të humbur në të gjitha mënyrat.

L. H. – 34 vjeç

pa LSSH janë të detyruar të paguajnë për shërbime shëndetësore, përfshirë shërbimet shëndetësore të ofruara nga qendrat e shëndetit publik. Gjithashtu, Romët e pajisur me LSSH duhet të paguajnë pagesa shtesë për shërbime të specializuara që nuk mbulohen nga LSSH ose nuk ofrohen nga institucione të shëndetit publik për disa arsye.

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe i librezave të sigurimit shëndetësor është falas për fëmijët, pavarësisht nga gjendja e papunësisë të prindërve të tyre. Megjithatë, ka dy probleme kryesore në lidhje me kujdesin shëndetësor të fëmijëve:

- Për shkak të nivelit të tyre të ulët kulturor dhe arsimor, mosbesimit në sistemin e kujdesit shëndetësor, shkeljeve të të drejtave të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë trajtimin degradues nga profesionistë të kujdesit shëndetësor, pengesat e komunikimit etj, shumë prindër romë kërkojnë trajtim mjekësor për fëmijët e tyre vetëm në një fazë të avancuar të sëmundjes. Kjo konfirmohet qartë nga dëshmi të ndryshme dhe nga perceptimi i niveleve më të larta të vdekshmërisë të regjistruara tek fëmijët romë në krahasim me fëmijët jo-romë;
- Shumë prej prindërve romë nuk mund të përballojnë pagesën e një grupi medikamentesh ose analiza specifike mjekësore që nuk ofrohen nga institucionet e shëndetit publik, veçanërisht nga spitalet për arsye të ndryshme por të kërkuara nga personeli mjekësor. Kjo përbën shqetësim veçanërisht në rastin e kujdesit spitalor.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për pamundësinë e tyre për të paguar kostot e larta të shërbimeve shëndetësore, të rriturit romë pa LSSH janë tepër neglizhentë për shëndetin e tyre, duke kërkuar ndihmë mjekësore vetëm në një fazë shumë të avancuar të sëmundjes. Shumë shpesh në këto raste janë të detyruar të marrin para hua nga romë të tjerë, gjë që pasohet nga *efekti domino* i borxheve që çon në një shkatërrim total ekonomik. Mbështetja e kujdesit shëndetësor nga OJQ lokale dhe ndërkombëtare përfaqëson shpresën e vetme për ta në rast sëmundjesh të rënda.

6. STREHIMI

Mungesa e të dhënave të qarta


Strehimi është problemi i dytë kryesor i komunitetit rom në Shqipëri, që duhet të zgjidhet me përparësi (shihni gjithashtu pikën 5.1). Mungesa e strehimit, riparimit të shtëpive, legalizimit dhe çështjet e titujve të pronësisë, si dhe infrastruktura e pamjaftueshme konsiderohen nga komuniteti rom si disa prej problemeve më prioritare që duhet të zgjidhen.

Për sa i përket situatës së strehimit, familjet rome mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Familjet që jetojnë në shtëpitë e tyre me kushte optimale strehimi. Kjo lidhet kryesisht me familjet rome në gjendje shumë të mirë ekonomike dhe/ose që banojnë në të njëjtat zona me popullsinë jo-rome;
- Familjet që jetojnë në shtëpitë e tyre tashmë të legalizuara me kushte të këqija jetese dhe me nevojë urgjente për përmirësim/riparim të shtëpive të tyre dhe infrastrukture tjetër përkatëse;
- Familjet që jetojnë në barraka ose tenda të ndërtuara në "tokë të pazënë", afër rrugëve ose në brigjet e lumit, pa leje ndërtimi. Në disa raste barrakat dhe tentat janë ndërtuar në tokë private dhe ata i paguajnë qera pronarëve të tokës. Në të dyja rastet ekziston një rrezik potencial që të dëbohen me dhunë nga vendbanimet e tyre, duke mbetur pa strehë;
- Familjet që jetojnë në lagje të varfra tashmë të legalizuara por pa titull pronësie pasi nuk mund të paguajnë tarifrat përkatëse;
- Familjet që jetojnë në lagje të varfra në ndërtim të përkohshëm;
- Familjet me më shumë se 5 anëtarë familjeje që jetojnë në të njëjtën dhomë; dhe
- Familje të tjera që jetojnë në lagje të varfra të ndara që nuk plotësojnë standardet minimale të kushteve të jetesës.

Figura 21.

Cilat janë problemet më prioritare që duhet të zgjidhen në lidhje me strehimin?




Plotësimi i kushteve minimale të strehimit për komunitetin rom ishte përfshirë si objektivi parësor në SKPKJKR. Arritja e këtij objektivi ishte parashikuar nëpërmjet hapave të mëposhtëm kryesorë:

- identifikimi i familjeve në nevojë strehimi, madhësia e familjeve dhe kushtet e tyre aktuale të jetesës;
- identifikimi i shtëpive në nevojë riparimi;

- identifikimi i të drejtave të pronësisë ndaj tokës në të cilën Romët kanë ndërtuar shtëpitë e tyre;
- vlerësimi i nevojave për tokë dhe materiale ndërtimi;
- inkurajimi i komunitetit rom për të kontribuar me fuqi punëtore për punime ndërtimi dhe riparimi; dhe
- ndërtimi i shtëpive modeste jo të kushtueshme për familjet rome në kushtet më të këqija.

Figura 22.

Sipas mendimit tuaj, cilat janë kushtet e strehimit për shumicën e familjeve rome?



KU DO TË PËRFUNDOJMË?


Ka rreth 100 shtëpi në këtë të ashtuquajtur lagje. Kemi ndërtuar lagje të varfra në tokën e Teqes dhe pronarët e Teqes nuk ankohen pasi janë fetarë por neve na mungojnë kushtet minimale të jetesës: 100 familje përdorin një çezëm që mezi rrjedh ujë me pika; nuk ka kanalizime ujërash të zeza për të gjithë "lagjen". Ndrërimi publik mungon në të gjithë lagjen dhe në orën gjashtë hyjmë në shtëpi se është errësirë e plotë. Dy ditë para zgjedhjeve vendore të vitit 2011 u instaluan pesë llamba shpejt e shpejt dhe na u duk sikur po i afroreshim Europës. Ne mbledheshim në mbrëmje rreth llambave dhe këndonim e kërcenim. Kjo zgjati vetëm një ditë pas zgjedhjeve sepse llambat u hoqën nga bashkia. Pas nesh kanë ardhur disa fshatarë nga zona të largëta. Ata ndërtuan shtëpi dhe tani kanë një lagje të re. Shtëpi u ka dhënë energji, ka vendosur rrjetin e ujërave të zeza dhe afër periudhës së zgjedhjeve iu shtrua rruga. Shumë mirë! I gjithë fshati vjen në qytet duke ndërtuar pa leje në një lagje qyteti. Atyre u janë plotësuar të gjitha nevojat, përfshirë legalizimin e shtëpive, ndërsa ne nuk kemi asgjë, as punë, as shtëpi, as energji, madje na mungojnë edhe dokumentet për barrakat tona (titujt e pronësisë). Nuk mund të paguajmë për to. Të ardhurit tani duan që të largohemi ne, duke pretenduar se është toka e tyre, duke na treguar dokumentet e tyre të pronësisë së tokës. Ku do të përfundojmë?

Thanasi, Gjrokastër

Megjithatë, mungon ky vlerësim teknik i përgjithshëm i strehimit të komunitetit rom, duke përfshirë veçanërisht familjet e pastreha rome, nevojat për riparim, familjet rome që jetojnë në lagje të varfra, dhe tregues të tjerë të kushteve të jetesës. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPTT) filloi në vitin 2006 ta kryente këtë vlerësim në pesë Bashki por nuk u morën masa të mëtijshme dhe nuk u evidentuan rezultate. Regjistrimi shqiptar i popullsisë i vitit 2011 ishte një mundësi e mirë për të pasqyruar qartë realitetin rom në lidhje me kushtet e strehimit por rezultatet përkatëse përfundimtare pritet të jenë mjaft të diskutueshme, duke marrë parasysh se të dhënat sasiore mbi madhësinë e komunitetit rom në Shqipëri, tashmë të konsideruara të pasakta (shihni pikën 3.1).

Figura 23.

Sipas mendimit tuaj, a angazhohet dikush për zgjidhjen e problemeve të strehimit për komunitetin rom?



Kushtet shumë të këqija të jetesës të komunitetit rom lidhen gjithashtu me aksesin e tyre të pakët në infrastrukturë. Mungesa e furnizimit me ujë është një problem i përhapur veçanërisht për familjet rome që jetojnë në vendbanime të ndara në periferi të qyteteve ose larg zonave urbane. Të njëjtat kushte ekzistojnë edhe për kanalizimet. Shumë prej familjeve rome banojnë në zona pa rrugë ose me rrugë të paasfaltuara ose rrugë në gjendje shumë të keqe. Ato kanë energji në shtëpi por ka mungesë të ndriçimit publik. Mungesa e furnizimit me ujë, përdorimi i burimeve të pakontrolluara të ujit dhe infrastruktura shumë e dobët kanë një ndikim të dukshëm negativ në gjendjen e tyre shëndetësore dhe infeksionet janë shumë të shpeshta, veçanërisht tek fëmijët.

Kjo situatë tregon se nuk ishte arritur objektivi i SKPKJKR -së në lidhje me mbulimin e të gjitha vendndodhjeve të vendbanimeve të popullsisë rome me furnizim uji, tubacione të ujërave të zeza dhe energji. Në fakt, SKPKJKR e ngarkoi MPPTT-në dhe institucionet e qeverisë vendore që të vlerësonin bashkërisht nevojat për furnizim me ujë dhe tubacione të ujërave të zeza, të realizonin punimet e nevojshme për përmirësimin e situatës dhe të përmirësonin higjienën dhe kanalizimet në territorin e lokaliteteve.

Në bazë të faktorëve të mësipërm, ekziston një diskriminim i hapur kundër komunitetit rom që shfaqet në kushtet shumë të këqija të strehimit dhe mungesën e pronësisë së shtëpive. Ky është gjithashtu perceptimi i komunitetit rom: pjesa më e madhe e të anketuarve pohoi se askush nuk është i angazhuar seriozisht për të zgjidhur problemet e tyre të strehimit.

Programet e strehimit social

Programet e Strehimit Social⁹¹ në Shqipëri menaxhohen nga një Njësi specifike e Koordinimit të Programit (NJKP) pranë MPPTT-së dhe përfshin dy komponentë kryesorë:

- Programin e strehimit social me kosto të ulët dhe
- Programin e strehimit social me anë të qerasë.

Programi i strehimit social me kosto të ulët zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Strehimit pranë MPPTT-së dhe financohet nga buxheti i shtetit. Apartamentet blihen me kredi dhe paguhen në tarifa mujore: familja duhet të paguajë për një apartament 65 metra katrorë rreth 9,800 LEK në muaj. Familjet e pranueshme janë ato me të ardhura mujore të paktën 30,000 LEK dhe jo më shumë se 50,000 LEK në muaj. Lista paraprake e përfituesve përpilohet nga Bashkia dhe më pas vlerësohet nga Banka përkatëse. Kushti kryesor paraprak për financim në këtë rast përfshin të ardhurat mujore minimale të nevojshme.

Duke marrë parasysh se shumica e komunitetit rom është e papunë dhe/ose nuk ka të ardhura mujore të rregullta, familjet rome janë pothuajse të përjashtuara nga ky program. Pak prej tyre që përfitonin nga programi disa vjet më parë, po përballen aktualisht me vështirësi pagese dhe janë përballë rrezikut të penalizimit nga Bankat.

Programi i strehimit social të qerasë⁹² adreson nevojat për strehim të shtetasve me të ardhura shumë të ulëta. Në këtë rast, apartamenti zotërohet nga Bashkia dhe është dhënë me qera nga Bashkia, duke marrë në konsideratë një qera mujore sociale. Niveli maksimal i pagesës vjetore përcaktohet me ligj dhe nuk

STREHIMI SOCIAL

Unë kam marrë një kredi për shtëpi në vitin 1997 në kuadër të programit të strehimit social. Në atë kohë isha i punësuar. Tani jam i papunë. Jemi 7 veta në familjen tonë që jetojmë vetëm me asistencë sociale prej 2,400 LEK në muaj. Tarifa mujore e kredisë për shtëpinë është 12,600 LEK. Përveç kësaj, duhet të paguajmë rreth 3,000 LEK për furnizimin me energji dhe ujë dhe duhet të ushqehemi. Për sa i përket veshjes, kjo është jashtë çdo diskutimi. Është tërësisht e pamundur të kryejmë këto pagesa. Problemi është se nëse nuk paguajmë këstet e kredisë për 6 muaj, paditemi në gjykatë dhe pas kësaj zyra e përbarimit do të ekzekutojë vendimin e gjykatës dhe pas marrjes së shtëpisë na hedhin në rrugë të pastrehë. Ky nuk është problem vetëm i familjes sime. Nga katër familjet që morën një shtëpi në 1997, tre janë nxjerrë nga shtëpitë pasi nuk mund të paguanin kredinë.

R. S. Korçë

91 Termi zyrtar i përdorur në kuadrin përkatës ligjor shqiptar.

92 Ky program me një shumë totale 25 MEURO financohet pjesërisht nga CEB (15 MEURO), duke synuar ndërtimin e 1,100 apartaments.

tejkalon 4% të kostos së ndërtimit të godinës⁹³. Qeraja mujore e çdo familjeje nuk duhet të tejkalojë 25% të të ardhurave mujore familjare. Nëse kjo nuk është e mundur, Bashkia do të subvencionojë deri 50% të qerasë mujore. Kriteret e hollësishtme të vlerësimit për aplikantët miratohen nga Këshilli Bashkiak.⁹⁴


Kështu, një shembull tipik është Vendimi i Këshillit Bashkiak të Elbasanit që përcaktoi kriteret⁹⁵ e mëposhtme kryesore të vlerësimit:

- *Gjendja e strehimit* – 30 pikë në total, duke përfshirë mungesën e shtëpisë së zotëruar – 7.5 pikë; shtëpitë në rrezik shembjeje – 5 pikë; shtëpia e mbipopulluar – 5 pikë; i detyruar për t’ia dhënë shtëpinë në dorëzim ish pronarëve – 12.5 pikë;
- *Kushtet sociale* – 20 pikë në total;
- Kushtet sociale – 20 pikë në total, përfshirë personat me aftësi të kufizuara – 4 pikë; jetimët – 4 pikë; emigrantët e kthyer – 4 pikë; familjet e policëve të vrarë – 4 pikë; viktimat e dhunës në familje – 4 pikë;
- *Gjendja ekonomike* – 30 pikë në total të ndara në tre kategori të ardhurash: më pak se 80 për qind të të ardhurave mesatare, nga 80 deri 100% të të ardhurave mesatare, dhe nga 100 deri 120% të të ardhurave mesatare.

Në bazë të shembullit të mësipërm, është e qartë se komuniteti rom nuk konsiderohet një grup specifik i synuar në këtë program dhe kushtet e strehimit të romëve nuk janë trajtuar siç duhet:

- Në *gjendjen e strehimit* nuk janë parashikuar familjet rome që jetojnë në lagje të varfra;
- Në *kushtet sociale* nuk janë përfshirë familjet rome; dhe
- Në *gjendjen ekonomike* nuk parashikohen familjet pa të ardhura.

Figura 24.
A ka programe specifike strehimi për komunitetin rom?



Më pas, NJKP përkatëse e MPPTT-së i dërgoi Bashkive “sugjerimet” e mëposhtme për shqyrtim:⁹⁶

- Familjet e detyruara për t’ia dhënë në dorëzim shtëpinë ish pronarëve – 20 pikë në total;
- Shtëpitë në rrezik shembjeje – 10 pikë;
- Familjet me nevoja specifike – 20 pikë në total, duke përfshirë pensionistët – 5 pikë, personat me aftësi të kufizuara – 10 pikë dhe jetimët – 5 pikë;
- Familjet në vështirësi financiare – 10 pikë në total, duke përfshirë familjet e divorcuara- 5 pikë dhe familjet me më shumë se 4 fëmijë – 5 pikë;
- Familjet me nevoja strehimi – 10 pikë në total, duke përfshirë familjet e sapokrijura 2 pikë, familjet e policëve të vrarë – 3 pikë, dhe familjet rome dhe egjiptiane – 5 pikë; (vi) Kushtet ekonomike – 30 pikë në total të ndara në tre kategori të ardhurash: më pak se 75% të të ardhurave mesatare, niveli i mesëm dhe niveli maksimal.

93 Të gjitha ato janë njësi të saponërtuara.

94 Sipas Ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004, “Mbi programet e strehimit social” dhe VKM Nr 574, datë 29.08.2012, “Dokumentet për aplikim për programet e strehimit social”.

95 Vendimi Nr. 82, datë 26.10.2012.

96 Udhëzimet e NJKP-së të datës 3.12.2012.

Komuniteti rom nuk konsiderohet si grup i synuar specifik as në këtë shembull. Familjet rome (ose egjiptiane) përfitonin 5 pikë nga 100 pikë në total; komuniteti rom nuk merret në konsideratë drejtpërdrejt në kriteret (i), (iii), dhe (iv); dhe konsiderohet si të gjitha familjet në nevojë në kriteret (ii) dhe (v).

Vendimet e mësipërme administrative tregojnë qartë se programi i strehimit social është një program i përgjithshëm që trajton probleme strehimi të familjeve në nevojë dhe nuk është një program i dedikuar për familjet rome. Përveç kësaj, demonstron se ky program është gjithashtu një instrument që trajton problemet e përditshme të Qeverisë. Rasti i kthimit të shtëpive ish pronarëve mund të paraqitet si shembull tipik: menjëherë pas miratimit të Ligjit për kthimin e shtëpive ish pronarëve,⁹⁷ Qeveria kërkoi të zgjidhte këtë ngërç nëpërmjet programit të strehimit social, duke i dhënë kësaj çështjeje më shumë rëndësi në vlerësim. Sipas rezultateve të një studimi të kohëve të fundit,⁹⁸ rreth 15% e të anketuarve romë kanë aplikuar për strehim social përse 1.5% e tyre raportojnë të kenë përfituar vetëm nga programet e strehimit social.

7.2.10 Ndërsa njihet si një nga komunitetet më të varfra në Shqipëri që jetojnë në kushte shumë të këqija strehimi dhe infrastrukturore, komuniteti rom nuk përfiton aspak nga programet e strehimit social. Si rezultat, mundësitë e tyre të integritit janë tepër të kufizuara nga ndarja e tyre fizike nga popullsia jo-rome.

97 Ligji Nr 82, datë 13.09.2012.

98 PNUD, Studim i vlerësimit të nevojave për komunitetet rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012.

SHTOJCA: PYETËSORI

61

shqipëri

Pyetje të përgjithshme

1.1 A jeni informuar mbi ekzistencën e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi?

1. Po 2. Jo 3. Nuk e di

1.2 A mendoni se komuniteti rom është i diskriminuar në Shqipëri?

1. Po 2. Jo 3. Nuk e di

1.3 Nëse po, cilët janë më të diskriminuar?

1. Të gjithë Romët 3. Gratë rome 5. Fëmijët romë
2. Romët me aftësi të kufizuara 4. Romët e papunë 6. Romët lypës

1.4 Nëse po, nga kush janë më të diskriminuar?

1. Nëpunësit qev. 3. Jo-romët 5. Fëmijët jo-romë
2. Punëdhënësit 4. Mësuesit 6. Policia

1.5 Cilat janë institucionet që ndihmojnë më shumë në zgjidhjen e problemeve të komunitetit rom?

1. Sekret. Teknik 4. Bashkitë 7. Zyrat e Punësimit
2. Ministrinë 5. DRA-të 8. KMD
3. OJQ-të 6. Avokati i Popullit 9. Shërbimi Social Shtetëror

1.6 Si i vlerësoni përpjekjet e Qeverisë (ve) për të zgjidhur problemet kryesore të komunitetit rom?

1. Të mjaftueshme 2. Aspak të mjaftueshme 3. Nuk e di

1.7 Nëse janë të pamjaftueshme, sipas mendimit tuaj cilat janë arsyt kryesore?

1. Mungesa e angazhimit 4. Presioni i ulët nga komuniteti rom
2. Mungesa e financimit 5. Interesi i ulët i qeverisë vendore
3. Mungesa e Strategjive 6. Nuk e di

1.8 Cilat janë problemet kryesore të komunitetit rom që duhet të zgjidhen me prioritetin më të lartë?

- | | | | | | |
|-------------------------|--------------------------|-----------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 1. Të drejtat e njeriut | <input type="checkbox"/> | 4. Punësimi | <input type="checkbox"/> | 7. Ndërgjegjësimi | <input type="checkbox"/> |
| 2. Arsimi | <input type="checkbox"/> | 5. Kushtet e jetesës | <input type="checkbox"/> | 8. Strehimi | <input type="checkbox"/> |
| 3. Diskriminimi | <input type="checkbox"/> | 6. Të drejtat e grave | <input type="checkbox"/> | 9. Të drejtat e fëmijëve | <input type="checkbox"/> |

1.9 Ju lutem përshkruani një shembull diskriminimi që iu ka ndodhur juve ose familjes suaj.

2 Arsimi

2.1 Sipas mendimit tuaj, a është arsimi i nevojshëm për fëmijët tuaj?

1. Jo 2. Po 3. Në njëfarë mase 4. Nuk e di

2.2 A ka raste kur fëmijët romë janë ndarë në klasa të veçanta?

1. Disa raste 2. Jo 3. Nuk e di

2.3 A ka informacion mbi historinë rome në tekste shkollore?

1. Po 2. Jo 3. Nuk e di

2.4 A mendoni se historia rome duhet të përfshihet në tekste shkollore?

1. Jo 2. Po 3. Sigurisht që po 4. Nuk e di

2.5 Përse regjistrimi në shkollë i fëmijëve romë është shumë i ulët?

- | | | | | | |
|---------------------|--------------------------|-------------------------|--------------------------|--------------------------------|--------------------------|
| 1. Nuk kanë interes | <input type="checkbox"/> | 4. Varfëria | <input type="checkbox"/> | 7. Nuk ka tekste shkollore | <input type="checkbox"/> |
| 2. Nuk ka shkolla | <input type="checkbox"/> | 5. Lëvizshmëria | <input type="checkbox"/> | 8. Cilësi e ulët mësimdhënieje | <input type="checkbox"/> |
| 3. Diskriminimi | <input type="checkbox"/> | 6. Largësia nga shkolla | <input type="checkbox"/> | 9. Nuk e di | <input type="checkbox"/> |

2.6 Sipas mendimit tuaj, përse nuk ka shumë fëmijë romë në arsimin dytësor?

2.7 Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet bërë për të rritur nivelin e regjistrimit të romëve në arsimin dytësor dhe tretësor?

3 Punësimi

3.1 Sa persona jeni në familjen tuaj?

1. Të rritur 2. Fëmijë 3. Totali

3.2 Cilat burime të ardhurash dhe sa para keni në familjen tuaj?

Paga mujore _____ Lekë në muaj
 Ndhima ekonomike _____ Lekë në muaj
 Ndhima nga papunësia _____ Lekë në muaj
 Remitancat _____ Lekë në muaj
 Punësimi joformal _____ Lekë në muaj
 Të ardhurat nga fëmijët _____ Lekë në muaj
 Pa të ardhura të rregullta _____ Lekë në muaj
 Lypja _____ Lekë në muaj
 Thurja e shportave _____ Lekë në muaj

3.3 Përse niveli i papunësisë së komunitetit rom është kaq i lartë?

1. Migrimi 3. Mungesa e aftësive 5. Mungesa e asistencës
 2. Diskriminimi 4. Mungesa e punës 6. Nuk kanë interes

3.4 A ekzistojnë politika specifike qeveritare që nxisin punësimin e komunitetit rom?

1. Po 2. Jo 3. Nuk e di

3.5 A keni mundësi për të hapur një biznes me qëllim vetëpunësimin?

1. Po 2. Ndoshta 3. Jo, aspak

3.6 Nëse jo, cilat janë pengesat kryesore?

1. Nuk kanë njohuri 4. Mungesë financimi
 2. Mungesë mbështetjeje qev. 5. Mungesë mbështetjeje qev.
 3. Diskriminimi 6. Nuk e di

3.7 Çfarë duhet bërë për nxitjen e punësimit të komunitetit rom?

4 Kujdesi shëndetësor

4.1 A ndjeni diskriminim në shërbimin shëndetësor që ju është ofruar në krahasim me popullsinë jo-rome?

1. Jo 2. Po 3. Nuk e di

4.2 Nëse po, ju lutem përshkruani

4.3 A keni librezë sigurimi shëndetësor?

1. Jo 2. Po

4.4 Nëse jo, për çfarë arsyeje?

1. Mungesë interesi
2. Mungesë parash
3. Papunësia
4. Nuk e di

4.5 Nëse jo, ju lutem përshkruani sesi përfitoni nga ndihma mjekësore?

4.6 A ka ndonjë qendër shëndetësore afër banesës suaj?

1. Po 2. Jo

4.7 Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet bërë për të zgjidhur problemet e kujdesit shëndetësor të komunitetit rom?

5 Strehimi

5.1 Cilat janë problemet më prioritare që duhet të zgjidhen në lidhje me strehimin e komunitetit rom?

1. Infrastruktura e pamjaftueshme
2. Legalizimi i shtëpive
3. Mungesa e strehimit
4. Mungesa e planeve urbane
5. Riparimi i shtëpive
6. Pamundësia për të ndërtuar shtëpi të re
7. Mungesa e financimit të kredisë
8. Pamundësia për të paguar qira mujore

5.2 Sipas mendimit tuaj, cilat janë kushtet e strehimit për shumicën e familjeve rome?

1. Tendat dhe barrakat
2. Më shumë se 5 persona në një dhomë
3. Shtëpi me nevojë urgjente riparimi
4. Lagje të varfra pa leje ndërtimi
5. Zona të përziera me popullsi jo rome
6. Kushte optimale strehimi
7. Shtëpi të tyre me kushte jetese të varfra

5.3 Sipas mendimit tuaj, a është dikush i angazhuar për zgjidhjen e problemeve të strehimit për komunitetin rom?

1. Askush 2. Po 3. Nuk e di

5.4 A ka programe specifike strehimi për komunitetin rom?

1. Jo 2. Po 3. Nuk e di

5.5 Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet bërë për zgjidhjen e problemeve të strehimit të komunitetit rom?

6 Pyetje përmbyllëse

6.1 Ju lutem jepni ndonjë mendim tjetër që mund të keni në lidhje me problemet e komunitetit rom!



BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta Shqiptare, tetor 1998.
- Brunër, G. Nemzetisegi kerdes es kisebbsegi konfliktusor Kelet-Europaban, Budapest, 1995.
- Bugajski, J. Politikat Etnike në Europën Lindore, NY, 1994.
- Qendra për Dokumentacionin dhe Informimin për Minoritetet në Europë-Europa Juglindore, Romët e Shqipërisë, gusht 2000.
- CEES, Shpërndarja e fëmijëve romë në Shqipëri, nëntor 2011.
- Direktiva e Këshillit 2000/43/KE, qershor 2000.
- De Soto, etj., Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri – Nga Përjashtimi Social në Përfshirjen Sociale, Banka Botërore, mars 2005.
- Raport Progresi i KE-së – Shqipëri 2006.
- Raport Progresi i KE-së – Shqipëri 2007.
- Raport Progresi i KE-së – Shqipëri 2008.
- Raport Progresi i KE-së – Shqipëri 2009.
- Raport Progresi i KE-së – Shqipëri 2010.
- Raport Progresi i KE-së – Shqipëri 2011.
- Raport Progresi i KE-së – Shqipëri 2012.
- VKM Nr. 8, datë 5.01.2002.
- VKM Nr. 632, datë 18.09.2003.
- VKM Nr. 47, datë 16.01.2008.
- VKM Nr. 48, datë 16.01.2008.
- VKM Nr. 142, datë 23.02.2011.
- VKM Nr. 582, datë 27.07.2011.
- VKM Nr. 27, datë 11.01.2012.
- VKM Nr 574, datë 29.08.2012.
- VKM Nr. 82, datë 26.10.2012.
- HDPC, ILO, Mbledhja e të Dhënave për Grupet Vulnerabil në Rrezik të Përjashtimit nga Tregu i Punës, Tiranë, nëntor 2012.
- Udhëzimi i MPÇSSH-së, Nr. 76, datë 14.01.2004 “Mbi zbatimin e VKM-së Nr. 632”.
- Ligji Nr. 9232, datë 13.05.2004.
- Ligji Nr.33, datë 22.04.2010.
- Ligji Nr.34, datë 20.05.2010.
- Ligji Nr. 10221, datë 4.02.2010.
- Ligji Nr. 82, datë 13.09.2012.
- MASH, Vjetari Statistikor, 2010.

Koordinatori Kombëtar për Anti-Trafikimin, Raport mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Tiranë, shkurt 2012.

SHKP, Statistika në vite, 2012.

OSFA, Studim Krahasues mbi Faktorët që Prekin Shkallën e Integritit të Komunitetit Rom në Shqipëri, Rezultatet Paraprake, 2011.

Udhëzimet e NJKP-së të datës 3.12.2012.

Poulton, H, Ballkani: Minoritetet dhe Shtetet në Konflikt, Londër, 1991.

Raport i Komisionierit për Parlamentin Shqiptar, 22 shkurt 2012.

Raport në Mbledhjen e Tretë BE-Shqipëri në kuadrin e MSA-së; raport në Sesionin e 79-të të Komitetit për Anti-Diskriminimin në Gjenevë.

Fondi i Arsimit Rom, Vlerësim i Vendit: Shqipëri, 2011.

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it për rezultatet përfundimtare të Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011, Tiranë, 13 dhjetor 2012.

Banka Botërore, Përmbledhje mbi Komunitetin Rom, prill 2010.

PNUD, Studim mbi vlerësimin e nevojave për komunitetet rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012.

Departamenti i Amerikan i Punës, Rezultatet mbi Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve- Shqipëri, tetor 2010.

Departamenti Amerikan i Shtetit, Raport i Vendit për Shqipërinë mbi Praktikatat e të Drejtave të Njeriut, janar 1997.

Ky raport u përgatit nga një koalicion i shoqërisë civile që përfshin organizatat e mëposhtme: Roma Active Albania (organizata drejtuese), Qendra e Nxitjes së Zhvillimit Njerëzor (HDPC), O Avipe i Romegno, Romano Sezi, Unioni Rom i Beratit.

Kërkuesi kryesor i koalicionit është Ylli Cabiri, Doktor i Shkencave (HDPC) dhe menaxheri i projektit është Adriatik Hasantari (RAA). Autorët e raportit janë: Ylli Cabiri (Autori Udhëheqës), Adriatik Hasantari (RAA), Lindita Rama, Doktore e Shkencave (HDPC), Ilvia Bajrami (RAA), Dritan Ziu (RAA), Gerta Xega (RAA), Latif Kazanxhiu (RAA), Enver Mustafaj (Romano Sezi), Laver Myrteli (Unioni Rom i Beratit), Selvie Rushiti (O Avipe i Romengo), Renart Koci (student), Albana Nuredini (studente) dhe Hafize Peqini (studente).

Në projekt janë angazhuar, gjithashtu, personat e mëposhtëm: Renard Koci, Blerina Zoto, Albana Nuredini, Hafize Peqini, Anila Harapi, Klaudia Veizaj, Ina Majko, Ledia Rushit, Klaudio Taho, Daniel Hyseni, Erion Mejdani, Xhekson Çela, Saimir Kazanxhiu, Donika Rrapushi, Eva Tare dhe Egla Rrapushi.

Gjatë përgatitjes së raportit janë përfshirë edhe organizatat e mëposhtme: Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome, Departamenti i Politikës Publike i Universitetit European Qendror, Qendra Europiane e të Drejtave Rome, Organizata "Habitat for Humanity", Fondi i Arsimit Rom dhe nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur: Shfrytëzimi i Fondeve të BE-së për Programin Rom, Zyra e Iniciativave Rome dhe Programi Rom mbi Shëndetësinë.

Në vitin pilot 2012, Sekretariati i Dekadës Rome vendosi të mbështesë raporte nga koalicionet e shoqërisë civile në shtatë vende (Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Maqedonia, Rumania, Sllovakia, dhe Spanja) dhe Zyra e Iniciativave Rome autorizoi një raport shtesë nga Republika Çeke. Përveç kësaj, Sekretariati i Dekadës Rome publikoi një model, me qëllim nxitjen e aktorëve të tjerë të shoqërisë civile për të monitoruar zbatimin e Strategjive Kombëtare për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Planet e Veprimit të Dekadës Rome.

Në këto raporte, koalicionet e shoqërisë civile plotësojnë ose paraqesin informacion alternativ të Raporteve të Progresit të Dekadës Rome të paraqitura nga Qeveritë Pjesëmarrëse në Dekadën e Përfshirjes Rome dhe për çdo raport të paraqitur nga Shtetet palë në Komisionin European mbi zbatimin e Strategjive të tyre. Këto raporte nuk synojnë të zëvendësojnë monitorimin dhe vlerësimin sasior nga autoritetet shtetërore por të kanalizojnë njohuritë lokale në proceset e politikave kombëtare dhe europiane dhe të reflektojnë mbi ndikimin social real të masave qeveritare. Raportet e shoqërisë civile ofrojnë të dhëna shtesë ndaj atyre zyrtare, të dhëna përfaqësuese, kur nuk ka të dhëna zyrtare, ose interpretim alternativ të të dhënave të publikuara.

Projekti koordinohet nga Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome në bashkëpunim me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur – Shfrytëzimi i Fondeve të BE-së për Programin Rom dhe Zyrën e Iniciativave Rome.



DECADE OF
ROMA INCLUSION
2005-2015
www.romadecade.org



OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS

Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation

Teréz körút 46.

1066 Budapest, Hungary

www.romadecade.org